



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Drejtim i SME-ve”

ofruar nga

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof Asoc. Dr. Etleva Leskaj

Dr. Valbona Kapllani

Nëntor 2025

**Tabela me të dhënat përmbledhëse për Programin e studimit Master Profesional në:
“Drejtim i SME-ve”, ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës**

| | | |
|----|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Menaxhimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr.1161, datë 25.11.2009 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | UMASR Nr. 7243/1, datë 22.08.2018. |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhëri Nr.275, datë 22.10.2020 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA Nr. 03, datë 22.01.2021 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë i studimeve |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | Një vit akademik / 2 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 60 kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 (shtatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2023-2024 :6 PAE / 2PAK 2024-2025:5 PAE / 2PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2023-2024: 5 studentë 2024-2025: 2 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD) ka hapur dyert në vitin akademik 2006-2007 me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005. UAMD ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Vlerësimi i fundit institucional është finalizuar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 24.03.2022 "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD)", me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 23.03.2026.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD) është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në pesë njësi kryesore:

- Fakulteti i Biznesit
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Studimeve Profesionale
- Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në "Drejtim i SME-ve", me 60 kredite ofrohet nga Fakulteti i Biznesit (FB), që përbëhet nga 6 njësi bazë:

- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Statistikës dhe i Informatikës së Zbatuar
- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Turizimit

Departamenti i Menaxhimit pranë FB është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Drejtim i SME-ve", me 60 kredite. Ky program studimi është hapur në vitin akademik 2009-2010, si Master Profesional në "Ekonomi Biznes me profile a. Financë Bankë; b. Drejtim i SME-ve", me vendimin nr. 1, datë 26.03.2009 të Senatit akademik të UAMD-së dhe me VKM Nr. Nr.1161, datë 25.11.2009. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati i UAMD-së ka vendosur për riorganizimin e këtij programi në programi studimi të ciklit të dytë Master Profesional në "Drejtim i SME-ve", me 60 kredite (Vendimi i Senatit Nr. 105, datë 14.06.2018). Ky riorganizim ka marrë miratimin e MASR me shkresën Nr. 7243/1, datë 22.08.2018.

Në vitin 2021, programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në "Drejtim i SME-ve", me 60 kredite i është nënshtruar procesit të akreditimit për herë të parë nga ASCAL dhe ka marrë vlerësimin pozitiv me disa rekomandime nga Bordi i Akreditimit, me vendimin Nr. 03, datë 22.01.2021, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe afat vlefshmërie deri më 30.09.2023.

Programi i studimit është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësive kryesore të institucionit të arsimit të lartë. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar kryesisht në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale një vit akademik (dy semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, me 60 kredite.

Objektivi kryesor i këtij programi është pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike për të menaxhuar me sukses njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (NJVM). Përmes kombinimit të njohurive teorike me ato praktike, programi synon nxitjen e nismave sipërmarrëse të studentëve, si dhe aftësimi i tyre në hartimin dhe ndjekjen e projekteve sipërmarrëse dhe planeve të biznesit. Gjithashtu, ky program studimi synon përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për të menaxhuar NJVM, duke u thelluar njohuritë në tipare të veçanta të këtyre njësive, në sfidat e tregut, si dhe në vlerësimin e treguesve të menxhimit për arritjen e objektivave të tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në datën 06.06.2023, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD) ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Drejtimit i SME-ve". ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Asoc. Dr. Etleva Leskaj**, pedagoge pranë Fakultetit të Ekonomisë të UT, Departamenti i Menaxhimit dhe **Dr. Valbona Kapllani**, pedagoge pranë Fakultetit të Ekonomisë të UT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Alma Arapi**.

Në datën 16.07.2025 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datën 25 shtator 2025 në ambientet e UAMD. Gjatë vizitës ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 3 tetor 2025.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara nga ekspertët, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master Profesional në "Drejtimit i SME-ve", me 60 kredite.

Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 167 / 69 Prot, datë 03.11.2025. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës njofton në ASCAL më datë 06.11.2025, që nuk ka komente mbi draft-raportin. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.3, datë:22.01.2021 janë:

1. Institucioni, të rekrutojë personel të ri akademik, me tituj dhe grada, për të mundësuar mbulimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70% nga personeli akademik efektiv (PAE) në përmbushje të detyrimeve ligjore.
2. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit lëndë karakterizuese për të mundësuar studentëve të thellohen, specifikisht në problemet e menaxhimit të SME-ve si dhe për ti ofruar atyre shprehje të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve në përputhje edhe me nevojat e tregut të punës.
3. Institucioni, të rishikojë dhe përditësojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
4. Institucioni, të hartojë një plan-buxhet të detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond të veçante për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
5. Institucioni, të përfshijë staf të pavarur ose ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve në kryerjen e funksioneve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
6. Institucioni, të realizojë një analizë të të dhënave të punësimit të studentëve të këtij programi studimi pas diplomimit të tyre.
7. Institucioni, të implementojë sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit edhe për stafin dhe studentët e këtij programi studimi duke siguruar akses në informacione dhe dokumenta, si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e këtij programi studimi.
8. Institucioni, të zbatojë parashikimet që i ngarkon Statuti i UAMD-së në Kreun VII të tij si edhe kuadri rregullator në fuqi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së institucionit.
9. Institucioni, të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës, në përputhje me kriteret, kërkesat ligjore dhe rregullore në fuqi.
10. Institucioni, të marrë masa për pasurimin dhe plotësimin e logjistikës IT dhe programeve kompjuterike.
11. Institucioni, të kryejë vlerësimin e njohurive dhe dijeve me shkrim, në mënyrë anonime.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Institucioni, të rekrutojë personel të ri akademik, me tituj dhe grada, për të mundësuar mbulimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70% nga personeli akademik efektiv (PAE) në përmbushje të detyrimeve ligjore.



GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, por edhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin pranë këtij programi studimi të një personeli akademik cilësor që aktualisht mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore (numër lëndësh dhe orë totale), në përputhje parashikimet ligjore në fuqi dhe kuadrin rregullator të UAMD.

2. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit lëndë karakterizuese për ti mundësuar studentëve të thellohen, specifiku në problemet e menaxhimit të SME-ve si dhe për ti ofruar atyre shprehje të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve në përputhje edhe me nevojat e tregut të punës.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur kryesisht**. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky program studimi në dy vitet e fundit është riorganizuar në masën nën 20%, megjithatë, ndryshimi i evidentuar lidhet vetëm me një korrigjim në emërtimin e një lënde – nga “Drejtim i avancuar projekti” në “Drejtim i avancuar i projekteve” – pa ndryshime në përmbajtje apo ndikim real në strukturën akademike të programit.

Institucioni duhet të shfrytëzojë mundësinë e riorganizimit të programit (nën 20%) për të pasuruar kurrikulën me lëndë karakterizuese ose me zgjedhje që lidhen drejtpërdrejt me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siç përmendet dhe në Standardet II.4 dhe II.5 të këtij raporti. Një riorganizim i tillë do ta bënte programin më të fokusuar në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse për menaxhimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, më të përshtatshëm ndaj kërkesave të tregut të punës dhe më konkurrues në tregun e studimeve pasuniversitare.

3. Institucioni, të rishikojë dhe përditësojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur kryesisht**. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi janë organizuar kryesisht në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, por, siç përmendet dhe në fushat II dhe III të këtij raporti, ka nevojë të rishihet syllabusi i disa lëndëve me qëllim përshirjen e disa temave/çështjeve dhe një formatim më të kujdeshëm.

4. Institucioni, të hartojë një plan-buxhet të detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond të veçante për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni ka vënë në zbatim një plan për mbështetjen e kërkimeve shkencore përmes aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Biblioteka e institucionit është pasuruar me literaturë bashkëkohore dhe ofron tashmë akses në burime online dhe katalogë elektronikë, duke përmirësuar ndjeshëm qasjen në materiale të specializuara.

5. Institucioni, të përfshijë staf të pavarur ose ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve në kryerjen e funksioneve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB, në dokumentacionin shoqërues, si dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni ka përfshirë ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve në proceset e vetëvlerësimit, duke filluar që nga përfshirja e tyre si anëtarë të GVB të këtij programi studimi. Gjithashtu, përfaqësues të studentëve gjenden edhe në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel UAMD dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Biznesit.

6. Institucioni, të realizojë një analizë të të dhënave të punësimit të studentëve të këtij programi studimi pas diplomimit të tyre.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Menaxhimit, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni dhe strukturat e Fakultetit të Biznesit, ka krijuar mekanizma funksionale për ndjekjen e ecurisë së punësimit të studentëve pas diplomimit, duke u mbështetur në të dhëna të mbledhura sistematikisht dhe bashkëpunime konkrete me sektorin privat dhe publik.

7. Institucioni, të implementojë sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit edhe për stafin dhe studentët e këtij programi studimi duke siguruar akses në informacione dhe dokumenta, si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e këtij programi studimi.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka konsoliduar përdorimin e sistemeve informatike dhe platformave digjitale, që garantojnë akses të drejtë, të lehtë dhe të sigurt në dokumentacionin akademik, administrativ dhe mbështetës për stafin dhe studentët, si dhe mbështetje teknike nga njësia e IT (platforma PITAGORA, emaili institucional për studentët dhe personelin, faqja zyrtare në internet e UAMD).

8. Institucioni, të zbatojë parashikimet që i ngarkon statuti i UAMD-së në Kreun VII të tij si edhe kadri rregullator në fuqi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së Institucionit.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB, në dokumentacionin shoqërues, si dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se me vendimin nr. 51, datë 19.05.2025 të Senatit Akademik të UAMD është miratuar zgjedhja e shtatë anëtarëve të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë.

9. Institucioni, të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës, në përputhje me kriteret, kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB, në dokumentacionin shoqërues, si dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kadri rregullator i UAMD parashikon qartë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive për çdo aktor të përfshirë në funksionimin akademik dhe administrativ të programit në përputhje me kriteret, kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

10. Institucioni, të marrë masa për pasurimin dhe plotësimin e logjistikës IT dhe programeve kompjuterike.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni, në përputhje me planet zhvillimore të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD, ka ndërmarrë masa të qëndrueshme për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës TI, si dhe zgjerimin e përdorimit të platformave dhe softuerëve kompjuterikë në funksion të procesit mësimor, kërkimor dhe administrativ.

11. Institucioni, të kryejë vlerësimin e njohurive dhe dijeve me shkrim, në mënyrë anonime.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përbushur plotësisht**. Sikurse raportohet në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pranë këtij programi studimi vlerësimi i njohurive dhe dijeve realizohet në përputhje me standardet akademike dhe parashikimet për vlerësimin të kadrut rregullator të UAMD-së.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: “Drejtim i SME-ve”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | <p>Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe me Statutin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, konstatohet se institucioni orientohet drejt zhvillimit të programeve të studimit që mbështesin interesin kombëtar dhe i përgjigjen nevojave të tregut të punës. Rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është projektuar për të përgatitur specialistë të aftë në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilët kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e performancës organizative dhe në zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit, duke pasur në konsideratë që dominanca e ekonomisë shqiptare janë NVM. Vërehet se programi është ndërtuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 (VKM Nr. 621) dhe Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 (VKM Nr. 542), duke siguruar përshtatshmëri ndërmjet objektivave akademike dhe orientimeve strategjike kombëtare. GVJ vlerëson se programi demonstroi lidhje të qartë ndërmjet misionit institucional, nevojave të tregut të punës dhe politikave kombëtare të zhvillimit, duke reflektuar angazhim të qëndrueshëm për cilësi akademike dhe kontribut në zhvillimin e vendit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD); Evidenca_Nr.16_(Kodi i Etikës në UAMD); Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD)]</i></p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me | GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është plotësisht i harmonizuar me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” |

| | |
|--|---|
| <p>qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Durrës dhe të njëjsteve të tij përbërëse, të cilat synojnë garantimin e një formimi akademik dhe profesional në përputhje me standardet bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi mbështetet në dispozitat e Statutit të UAMD-së (nenet 3 dhe 4) si dhe në dokumentet strategjike zhvillimore të universitetit, duke dëshmuar përkushtimin institucional ndaj cilësisë në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe formimin profesional të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se programi është projektuar për të zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara teorike e praktike në drejtim dhe menaxhim të bizneseve të vogla dhe të mesme, duke synuar përgatitjen e specialistëve të aftë për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Programi promovon aftësinë analitike të studentëve për të vlerësuar situata konkrete të menaxhimit të SME-ve, aplikimin e strategjive efektive të drejtimit si dhe nxitjen e shpirtit sipërmarrës dhe inovativ.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr. 1_(Statuti i UAMD; Evidenca_Nr.2_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025; Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i programit si dhe nga takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, konstatohet se programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është i strukturuar në përputhje me profilin akademik dhe drejtimet kërkimore të Departamentit të Menaxhimit, duke siguruar një lidhje të qartë ndërmjet objektivave akademike dhe përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p>Nga analiza e dokumentacionit rezulton se programi zhvillohet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të Universitetit, Fakultetit dhe Departamentit, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, zhvillimit të rajonit dhe nevojave të shoqërisë. Vërehet se ofrimi i programit realizohet në përputhje me Statutin dhe rregulloret e UAMD-së, ndërsa përmbajtja e tij përqendrohet në zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike mbi menaxhimin bashkëkohor të bizneseve të vogla dhe të mesme. GVJ vlerëson se programi demonstroi koherencë ndërmjet misionit institucional, objektivave zhvillimore dhe kërkesave të tregut të punës, duke reflektuar një angazhim të qartë për cilësi</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>akademike dhe formim profesional të studentëve në fushën e NVM-ve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.2_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025); Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025); Evidenca_Nr.4_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025); Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD); Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> | <p>GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit tregojnë një angazhim të qëndrueshëm ndaj prioriteteve strategjike kombëtare. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me drejtuesit, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është konceptuar në përputhje me interesat kombëtare dhe tendencat globale të zhvillimit ekonomik. Programi është i integruar në vijimësinë e planeve strategjike të Universitetit, Fakultetit dhe Departamentit, duke reflektuar objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030, si dhe Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026.</p> <p>GVJ vlerëson se programi demonstroi koherencë ndërmjet misionit të institucionit dhe politikave kombëtare, duke mundësuar përgatitje cilësore dhe profesionale të studentëve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron që institucioni, të vlerësojë mundësinë rishikimit të emërimit, që emërtimi i programit të jetë në gjuhën shqipe, në përputhje me standardet akademike. Një emërtim në gjuhën amtare do ta bënte programin më të qartë, më orientues dhe më të aksesueshëm për grupin e synuar të studentëve, duke kontribuar njëkohësisht në forcimin e identitetit institucional dhe rritjen e dukshmërisë së programit në kuadrin kombëtar të arsimit të lartë. Kjo do të ndihmonte gjithashtu në reflektimin më të qartë të profilit profesional të programit.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.2_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025); Evidenca_Nr.3_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025);</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Evidenca_Nr.4 (Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025]</i> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programi Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve” është në përputhje me misionin dhe strategjitë e universitetit, adreson nevojat e tregut dhe prioritete kombëtare, dhe ofron përgatitje akademike dhe profesionale të avancuar.</i> - <i>Programi siguron koherencë ndërmjet objektivave institucionale dhe kërkesave të zhvillimit të vendit, duke kontribuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe zhvillimin ekonomik e shoqëror.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> | <p>GVJ, referuar dosjes së programit, konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”, i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit pranë Fakultetit të Biznesit që prej vitit akademik 2009–2010, mbështetet në përvojën e akumuluar, kapacitetet akademike dhe burimet institucionale të njësive përkatëse, të cilat sigurojnë realizimin efektiv të objektivave të programit.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik dhe nga vizita në institucion, rezultoi se stafi i angazhuar në program ka përvojë të konsiderueshme akademike, profesionale dhe kërkimore-shkencore, ndërsa infrastruktura ekzistuese — përfshirë laboratorët, bibliotekën dhe mjediset mësimore — është e përshtatshme për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</p> <p>Sipas dosjes së vetëvlerësimit, Fakulteti i Biznesit ka një staf akademik prej 140 pedagogësh, nga të cilët 70 janë me kohë të plotë (PAE) dhe 70 me kohë të pjesshme (PAK). Rezultoi se 45 prej tyre mbajnë titullin profesor, ndërsa 48 kanë gradën shkencore “Doktor”, duke përbërë gjithsej 93 anëtarë me grada dhe tituj akademikë, që përfaqësojnë 66% të stafit të fakultetit.</p> <p>GVJ vlerëson se kjo përqindje e lartë e stafit të kualifikuar përbën një bazë solide për ekspertizë akademike dhe</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>profesionale, duke garantuar cilësi në realizimin e programeve të studimit.</p> <p>Në përfundim, GVJ vlerëson se kombinimi i kapaciteteve njerëzore dhe atyre infrastrukturore siguron ofrimin e një programi të qëndrueshëm, të mirëstrukturuar dhe me standarde cilësie, në përputhje me objektivat akademike dhe nevojat profesionale të studentëve në fushën e drejtimit të NVM-ve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.56 Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Menaxhimit dhe në Fakultetin e Biznesit; Evidenca_Nr.52 Të Dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MP Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.84: CV stafi akademik; Evidenca_Nr.35_Fushat e Studimit për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit; Evidenca_Nr.44 Të Dhëna për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Konstatohet se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit të Biznesit, dhe të njësisë bazë, Departamentit të Menaxhimit. Rezulton se programi respekton klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, duke siguruar harmonizim me standardet akademike dhe kurrikulat ndërkombëtare. GVJ vlerëson se kjo përputhshmëri garanton koherencë ndërmjet objektivave akademike dhe kërkimeve profesionale të drejtimit të NVM-ve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.75_(Kodifikimi i Programeve në UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p> | <p>GVJ duke iu referuar planit mesimor, syllabuseve konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Menaxhimit, i cili administron këtë program, sipas Vendimit për fushat kërkimore-shkencore të departamentit dhe dispozitave të Rregullores për programin e studimit. Rezulton se hartimi dhe ofrimi i programit është në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit, duke respektuar Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 dhe</p> |




| | |
|--|---|
| <p>bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>udhëzimet kombëtare dhe europiane për standardet akademike. Vërehet se departamenti nuk ofron programe studimi ndërdisiplinore.</p> <p>GVJ vlerëson se programi është i harmonizuar me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Menaxhimit dhe zhvillohet në përputhje me standardet dhe rregulloret kombëtare në fuqi, duke siguruar koherencë ndërmjet objektivave të programit, përmbajtjes mësimore dhe profilit akademik të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.82_Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit; Evidenca_Nr.9_Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p> | <p>NA</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>Referuar takimeve me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si dhe me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës, GVJ konstaton se Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit u ofrojnë studentëve të diplomuar mundësi për trajnime dhe zhvillim profesional të mëtejshëm nëpërmjet bashkëpunimeve me institucione publike dhe kompani private, me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Gjithashtu, Panairi i Punës, i organizuar çdo vit nga Fakulteti, ofron mundësi konkrete për punësim dhe praktika profesionale (internshipe), duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin profesional dhe integrimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p>GVJ vlerëson se këto iniciativa përbëjnë praktika të mira institucionale, të cilat forcojnë lidhjen ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, promovojnë eksperiencën praktike të studentëve dhe mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit;</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Evidenca_Nr.64_(Vendime për grupet e punës në Panairin e Punës; Evidenca_Nr.64.1_(Raporti i Panairit të Punës 2025)</i> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka një eksperiencë të gjatë akademike dhe disponon kapacitete të qëndrueshme infrastrukturore dhe njerëzore.</i> - <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është menaxhimi i biznesit, në përputhje me fushën e studimit të njësisë bazë, Departamentit të Menaxhimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës operon me ndarje të qarta të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet njësive dhe personelit, si dhe me analizë të vazhdueshme të performancës së tyre. Rezulton se Statuti i UAMD përcakton organigramën e institucionit dhe lidhjet ndërmjet njësive, duke dalluar pjesën akademike, që përfshin organet dhe autoritetet drejtuese akademike në të gjitha nivelet, dhe pjesën administrative, që përfshin organet dhe autoritetet drejtuese administrative.</p> <p>Vërehet se organet drejtuese dhe të tjera përfshijnë Senatën Akademik, Rektoratin, Dekanatet, Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, Këshillin e Etikës, Komisionet e përhershme, NJSBC dhe Bordin e Administrimit, ndërsa autoritetet drejtuese përfshijnë Rektorin, Dekanin, Drejtuesin e Departamentit dhe Administratorin e Universitetit.</p> <p>Rezulton se Statuti dhe rregulloret e njësive kryesore dhe bazë përcaktojnë ndarje të qarta të përgjegjësi, ku Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor për të gjitha njësitë bazë, ndërsa Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë, është përgjegjës për</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve.”</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD); Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit); Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtimit i SME-ve)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> | <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion me drejtuesit dhe përfaqësues të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, rezulton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete vendase dhe të huaja, kompani private, institucione publike dhe organizata jofitimprurëse, me qëllim mbështetjen e objektivave formuese dhe profesionale të programit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”.</p> <p>GVJ vlerëson se këto partneritete zgjerojnë mundësitë për studentët dhe ka mundësi të forcojnë dimensionin ndërkombëtar dhe profesional të programit, pavarësisht kufizimeve në mobilitetin studentor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.85_(Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë); Evidenca_Nr.37.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së); Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit); Evidenca_Nr.66_(Shembull_Erasmus-International Agreement for Mobility for Staff and Students)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo</p> | <p>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit dhe në takimet e zhvilluara në institucion, konstaton se për organizimin e praktikave profesionale, institucioni ka zhvilluar një rrjet bashkëpunimesh me institucione jo-arsimore partnerë, duke ofruar studentëve mundësi të vlefshme për përvojë praktike dhe zhvillim profesional, një mbështetje e veçantë duke marrë parasysh numrin e reduktuar të studentëve në program. Programi Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve” përfshin një praktikë profesionale të strukturuar, e cila është thelbësore për përgatitjen profesionale të studentëve. Praktikrat realizohen</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>në institucione publike, kompani private dhe profesione të lira të identifikuara nga institucioni, dhe kryhen nën mbikëqyrjen e pedagogut përgjegjës dhe mentorit në biznes, duke mundësuar një ndërlidhje efektive midis njohurive teorike dhe praktikës profesionale.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.37.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së; Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit; Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit; Evidenca_Nr.36_(Shembull praktike MP Drejtim i SME-ve)]</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton në dosjen e vetëvlerësimit si dhe nga takimet në institucion se, Departamenti i Menaxhimit përfshin në analizën vjetore ndikimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke përfshirë mobilitetet e studentëve dhe stafit, vizitat studimore, leksionet e hapura dhe aktivitetet e tjera të lidhura me bashkëpunimet, të cilat kontribuojnë në realizimin e objektivave të programit dhe përmirësimin e cilësisë akademike.</p> <p>GVJ vlerëson se ky proces tregon një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme në vlerësimin e përfitimeve që rrjedhin nga partneritetet dhe bashkëpunimet institucionale.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024; Evidenca_Nr.49_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2023-2025; Evidenca_Nr.51_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit; Evidenca_Nr.50.1_(Aktivitetet mësimore-shkencore në FB për 2024-2025; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit)]</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konkludon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UAMD operon me ndarje të qarta të detyrave, të përcaktuara në organigramën institucionale, e cila pasqyron lidhjet dhe varësitë midis organeve dhe autoriteteve drejtuese. - Për realizimin e objektivave mësimore dhe formuese të studentëve, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me njësitë homologe vendase dhe ndërkombëtare, si dhe me aktorë të biznesit publik dhe privat. | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

| | | | | |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në Drejtim i SME-ve, ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me aktet nënligjore përkatëse, VKM nr. 41/2018, e ndryshuar. Programi organizohet me kohëzgjatje njëvjeçare dhe ngarkesë prej 60 kreditesh ECTS. Struktura e planit mësimor është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike, duke përfshirë lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në funksion të formimit profesional të studentëve. [Referenca: Evidenca_Nr.21_Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.41_Struktura e Programeve të Studimit në UAMD; Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MP Menaxhim Biznes; Evidenca_Nr.20_Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024] |
| Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku | GVJ vlerëson se programi i studimit demonstroi një qasje të qartë drejt formimit profesional të studentëve, duke integruar njohuritë teorike me aftësitë praktike. Përfshirja e lëndëve karakterizuese dhe ndërdisiplinore, si: <i>Menaxhim Logjistik, Drejtim i Avancuar Projekti, Menaxhim i Biznesit të Vogël dhe të Mesëm</i> , etj., siguron bazë njohurish në fushën e studimit. |

| | |
|--|---|
| <p>përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Kjo strukturë kontribuon në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për aplikimin praktik të koncepteve teorike dhe përgatit studentët për sfidat e mjedisit profesional në drejtimin e NVM-ve, duke forcuar lidhjen midis teorisë dhe praktikës në arsimimin e tyre profesional.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.21_Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.41_Struktura e Programeve të Studimit në UAMD; Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MP Menaxhim Biznes; Evidenca_Nr.20_Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është i strukturuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe udhëzimet përkatëse për ndarjen e ngarkesës në kredite ECTS. Programi parashikon 6 ECTS për praktikën profesionale dhe 10 ECTS për detyrimet përmbyllëse, përfshirë mikrotezën (temën e diplomës).</p> <p>Plani mësimor pasqyron ndarjen e lëndëve sipas tipologjisë së veprimtarisë akademike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lënda bazë: 5 ECTS (8.3% e totalit të krediteve); • Lëndët karakterizuese: 21 ECTS (35% e totalit); • Lëndët ndërdisiplinore: 21 ECTS, të përbëra nga 3 lëndë me zgjedhje nga 7 të ofruara, duke përfaqësuar rreth 30% të totalit të krediteve; • Detyrimet përmbyllëse: 10 ECTS (16% e totalit); • Praktika profesionale: 6 ECTS (10% e totalit). <p>GVJ vlerëson se struktura e planit mësimor mundëson balancë ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë, ofron fleksibilitet për zgjedhjen e lëndëve nga studentët dhe përmbush kërkesat ligjore për programet e ciklit të dytë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.21_Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.41_Struktura e Programeve të Studimit në UAMD; Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MP Menaxhim Biznes; Evidenca_Nr.20_Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024]</i></p> |

| | |
|---|------------|
| <p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>N/A</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p> | <p>Referuar RVB-së, dosjes së vetëvlerësimit dhe takimeve të zhvilluara me drejtuesit institucionalë, GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, paraqet një shkallë ngjashmërie prej rreth 70% me programe të ngjashme të ofruara nga institucione të arsimit të lartë jashtë vendit.</p> <p>Kjo strukturë programore lehtëson mobilitetin akademik dhe profesional të studentëve, si dhe rrit mundësinë e njohjes së diplomës në tregun ndërkombëtar të punës.</p> <p>GVJ vlerëson se përfshirja e mundësive për mobilitet në kuadrin e projekteve dhe programeve ndërkombëtare përbën një praktikë të mirë, që ndikon në cilësinë dhe konkurrueshmërinë e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.21_Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.41_Struktura e Programeve të Studimit në UAMD; Evidenca_Nr.5_Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MP Menaxhim Biznes; Evidenca_Nr.20_Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024]</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> | <p>Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe të dhënave nga takimet me drejtuesit, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është plotësisht në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë përgjegjëse për zbatimin e tij. Programi është harmonizuar me klasifikimin dhe kodifikimin kombëtar të programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 si dhe me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane për organizimin e programeve të këtij niveli. Ky program studimi mban kodin 71MP0413S.</p> <p>GVJ vlerëson se kjo përputhje tregon një koherencë të mirë institucionale ndërmjet fushës akademike të njësisë bazë dhe objektivave të programit, duke i shërbyer cilësisë dhe relevancës së tij në raport me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.75_Kodifikimi i Programeve në UAMD; Evidenca_Nr.21_Plani Mësimor në MP Drejtim i</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>SME-ve; Evidenca_Nr.41_Struktura e Programeve të Studimit në UAMD]</i> | | | |
| Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | N/A | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është i strukturuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe udhëzimet kombëtare e ndërkombëtare për organizimin e programeve të studimit.</i> - <i>Programi kombinon në mënyrë të balancuar lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, duke ofruar fleksibilitet për studentët dhe duke siguruar përmbushjen e objektivave formuese dhe profesionale.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|----------|------------------------|
|----------|------------------------|

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Referuar Statutit të UAMD, rregulloreve të Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit të Menaxhimit, dokumentacionit të programit të studimit dhe Udhëzimeve nr. 1 dhe 31, GVJ konstaton se Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit përmbushin në mënyrë të plotë detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit, duke u bazuar në kriteret specifike të tij. GVJ vëren se Departamenti i Menaxhimit ka një staf akademik të kualifikuar, përbërë nga 16 anëtarë:

- 1 me titullin Profesor,
- 4 me titullin Profesor i Asociuar,
- 8 me gradën Doktor Shkencash,
- 3 me titullin MSc.

Ky profil i stafit akademik ofron përvojë dhe ekspertizë për të siguruar zbatimin e programit dhe arritjen e objektivave akademike dhe profesionale.

Ndërsa në nivel njësia kryesore struktura akademike paraqitet si më poshtë:

| Cilësia e stafit të Fakultetit të Biznesit | | | | | | |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Titulli/Grada | 2022-2023 | | 2023-2024 | | 2024-2025 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 6 | 6 | 6 | 6 | 6 | 7 |
| Prof.Asoc. | 13 | 13 | 20 | 12 | 21 | 11 |
| Dr | 40 | 13 | 36 | 15 | 34 | 14 |
| Msc | 12 | 42 | 10 | 42 | 9 | 38 |
| Gjithsej | 71 | 74 | 72 | 75 | 70 | 70 |

| Stafi i Departamentit të Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit | | | | |
|--|-----------|-----|-----------|-----|
| Titulli/Grada | 2023-2024 | | 2024-2025 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK |
| | | | | |

| | | | | | |
|--|--|-----------|-----------|-----------|-----------|
| | Prof.Dr | 1 | 0 | 1 | - |
| | Prof.Asoc. | 3 | 3 | 4 | 3 |
| | Dr | 9 | 1 | 8 | 2 |
| | Msc | 3 | 10 | 3 | 10 |
| | Gjithsej | 16 | 14 | 16 | 15 |
| | <p>Për realizimin e procesit mësimor në programin e studimit MP në "Drejtimit i SME-ve", ndër vite janë të angazhuar kryesisht Personel Akademik Efektiv (PAE), nga tabelat e Programit të studimit është përpiluar tabela e stafit nga ku rezulton se për dy vite akademike 86% e stafit është staf akademik efektiv, si më poshtë:</p> | | | | |
| | | 2023-2024 | | 2024-2025 | |
| | Tituj/ grada | PAE | PAK | PAE | PAK |
| | Prof.Dr. | 1 | - | 2 | - |
| | Prof. Asoc. | 3 | 2 | 1 | 2 |
| | Dr./PhD. | 2 | - | 2 | - |
| | Msc. | - | - | - | - |
| | Totali | 6 | 2 | 5 | 2 |
| | <p>[Referenca: Evidenca Nr.53_ (Të Dhëna Tabelore me Ngarkesën e Plotë Mësimore të Stafit Akademik, në të gjitha programet; Vizita në institucion dhe tabelat e rishikuara]</p> | | | | |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | N/A | | | | |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse | GVJ konstaton se, sipas Rregullores së programit të studimit dhe Rregullores së Departamentit të Menaxhimit, Departamenti | | | | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>cakton një koordinator për programin e studimit, përgjegjës për përgatitjen dhe koordinimin e materialeve pedagogjike, organizimin e praktikave profesionale, udhëzimet për temën e diplomës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. GVJ vëren se koordinatori i programit Master Profesional në Drejtim i SME-ve është emëruar në vitin 2021 dhe mban gradën Doktor i Shkencave. Ky mekanizëm kontribuon në një menaxhim të strukturuar dhe të qëndrueshëm të proceseve akademike brenda programit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.86_(Vendime për Koordinatorët e Programeve; Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit)]</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit kanë vendosur një strukturë funksionale menaxhimi për programin Master Profesional në Drejtim i SME-ve. - Stafit akademik i Departamentit është i kualifikuar dhe përbëhet nga anëtarë me tituj dhe grada shkencore, duke i shërbyer realizimit të objektivave akademike dhe profesionale. - Emërimi i koordinatorit të programit, me gradën Doktor i Shkencave dhe përcaktimi i përgjegjësive të tij për materialet pedagogjike, praktikat profesionale dhe temën e diplomës sigurojnë një menaxhim të strukturuar, të qëndrueshëm dhe efektiv të proceseve mësimore brenda programit. | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p> | <p>GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është Fakulteti i Biznesit në UAMD, ndërsa njësia bazë përkatëse është Departamenti i Menaxhimit. Të dy njësitë disponojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, duke siguruar një ofrim të strukturuar dhe të qëndrueshëm të tij.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Dokumentacioni i depozituar nga institucioni, përfshirë Statutin e Universitetit, Rregulloret e Fakultetit dhe të programit të ciklit të dytë, kurrikulën e programit, planin mësimor, syllabuset dhe dokumente të tjera të lidhura, ofron një informacion të plotë dhe të detajuar i konsultuar nga GVJ. Ky nivel organizimi reflekton një qasje të strukturuar dhe profesionale në menaxhimin e programit dhe siguron që studentët të kenë një proces mësimor të mirëstrukturuar dhe të qëndrueshëm akademikisht.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.19_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MP Drejtim i SME-ve , 2024; Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024; VKM Nr.1161 datë 25.11.2009, për hapjen e programit të studimit të vitit 2009; Evidenca_Nr.18_(Vendimi për Hapjen e Programit të Studimit MP Drejtim i SME-ve Viti 2009; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> | <p>Programi i studimit për Master Profesional në Drejtim i SME-ve përfshin një plan mësimor të detajuar, i cili ofron informacion të plotë mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe moduleve, si dhe orët e zhvilluara brenda dhe jashtë auditorit. Sipas Rregullores së Fakultetit të Biznesit, programet e ciklit të dytë “Master Profesional” realizohen me 60 kredite dhe kanë një kohëzgjatje normale prej një viti, duke përfunduar me lëshimin e diplomës “Master Profesional”.</p> <p>Plani mësimor përfshin edhe lëndë me zgjedhje, të ofruara nga departamenti përgjegjës ose nga departamente të tjera. Rregullorja e programit përcakton mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies, duke përcaktuar qartë se cilat lëndë janë me detyrim dhe cilat me zgjedhje. Në total, programi përmban 9 lëndë, përfshirë Praktikën Profesionale dhe Mikro Tezën. Nga 7 lëndët e tjera, 4 janë lëndë me detyrim dhe 3 janë me zgjedhje. Plani mësimor përcakton gjithashtu orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit, si dhe detyrimet për secilën lëndë. Çdo kredit korrespondon me 25 orë, duke rezultuar në një total prej 1500 orësh për të gjithë programin. Kreditet ECTS janë të specifikuara për secilën lëndë, për praktikën profesionale dhe për mikrotezën, duke siguruar një strukturë të qartë dhe të ekuilibruar të ngarkesës mësimore.</p> <p><i>[Evidenca_Nr.8_(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <i>SME-ve ; VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 - Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë]</i> |
| Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | <p>Në Statutin e UAMD janë përcaktuar kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Këto kritere sqarohen më tej në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, në nenet 37–39 dhe në nenin 47. Për programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, Rregullorja specifikon kriteret e pranimit në nenet 6–8, ndërsa neni 22 përcakton kriteret për transferimin e studimeve të studentëve brenda programeve të ciklit të dytë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kriteret kryesore për njohjen e krediteve të grumbulluara nga studentët përfshijnë: ngjashmërinë e përmbajtjes së programit të studimit, kohën kur janë kryer studimet dhe përfshirjen e studentit në Sistemin e Bolonjës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.42_(Praktika për Transferim dhe Program të Dytë Studimi; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit]</i></p> |
| Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | <p>Referuar Rregullores së Fakultetit, GVJ konstaton se programi mësimor propozohet nga departamenti përkatës, miratohet nga Dekanati dhe paraqitet për miratim përfundimtar në Senatit Akademik; këtë procedurë e ka ndjekur edhe riorganizimi i tij. Programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset), duke përfshirë kreditet dhe orët që zhvillohen në leksione dhe seminare, brenda dhe jashtë auditorit, si dhe detyrimet për çdo modul. Puna individuale në secilën lëndë është e përcaktuar nga 65–100 orë, përveç mikrotezës, e cila kërkon 230 orë punë individuale. Syllabuset e lëndëve ofrojnë informacion të detajuar mbi lëndën, statusin e saj si zgjedhore ose me detyrim, semestrin e zhvillimit, kreditet ECTS, formën e mësimdhënies, mënyrën e kontrollit të dijes, literaturën, objektivat e modulit dhe temat që do të trajtohen. Lëndët me zgjedhje përbëhen nga 7 lëndë semestrale të ofruara nga departamenti përgjegjës për programin dhe nga departamentet e tjera. Programi mësimor përmban gjithashtu informacion mbi emërtimin e lëndës, tipin e veprimtarisë, orët e leksioneve dhe seminareve, lektorët</p> |

përkatës, semestrin, peshën e ECTS dhe objektivat specifike. Rregullorja e Fakultetit dhe ajo e programit përcaktojnë mënyrën e vlerësimit, sistemin e provimeve dhe kalueshmërinë. Syllabuset japin informacion mbi përqindjen që zënë elementët e ndryshëm në vlerësim: përmbushja e detyrimeve 100%, provimi i pjesshëm 400 pikë dhe provimi final 500 pikë, në një sistem prej 1000 pikësh. Pësia e elementëve të ndryshëm në vlerësim është e njëjtë për të gjitha lëndët. Sipas tabelës 15 të RVB-së, aktivizimi i studentëve aktualisht vlerësohet me 0 pikë, realizimi i detyrave të kursit me 10% të pikëve dhe 90% e vlerësimit realizohet përmes provimeve me shkrim. *GVJ konstaton se aktivizimi i studentëve dhe vlerësimi semestral (vetëm me detyrë kurs) për këtë program master në fushën e menaxhimit është i ulët, duke zënë vetëm 10% të vlerësimit final. Ky nivel i vlerësimit nuk nxit mjaftueshëm përfshirjen aktive të studentëve gjatë semestrit dhe interaktivitetin e tyre në grup, si dhe përdorimin e formave alternative të mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve, si detyrat individuale, detyrat e grupit apo forma të tjera alternative.*

Duke qenë se programi i studimit është program Master me profil Drejtim i SME-ve, *GVJ sugjeron që vlerësimi semestral, i cili orienton drejt përgatitjes së vazhdueshme të studentëve dhe rrit aktivizimin e tyre, të ketë një peshë më të madhe sesa 10% e vlerësimit total, duke përfshirë vlerësimin edhe të detyrave individuale, detyrave në grup apo dhe formave të tjera të aktivizimit gjatë semestrit përveç detyrës së kursit tashmë të parashikuar.*

Gjithashtu, referuar syllabuseve, GVJ konstaton se literatura bazë, ndihmëse ose e rekomanduar është e paazhurnuar; në disa raste mungon viti i publikimit, veçanërisht te ciklet e leksioneve që përdoren si literaturë bazë.

GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve për të përfshirë literaturë bashkëkohore, bazë dhe/ose ndihmëse, duke pasur parasysh ndryshimet e vazhdueshme dhe dinamike në njohuritë e përfshira në lëndët e këtij programi dhe në literaturën bashkëkohore në dispozicion.

[Referenca: Evidenca_Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2023-2024;

Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e

| | |
|--|--|
| | <p><i>Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.90_(Njoftime për studentët; Evidenca_Nr.19_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MP Drejtim i SME-ve, 2024; Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024; VKM Nr.1161 datë 25.11.2009, për hapjen e programit të studimit të vitit 2009]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p> | <p>GVJ, duke u bazuar në planin mësimor, riorganizimin e tij dhe syllabuset e konsultuara, konstaton se programet e studimit janë strukturuar në mënyrë që studentët të përftojnë njohuritë dhe aftësitë teoriko-profesionale të nevojshme, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <i>Megjithatë, shqyrtimi i syllabuseve tregon se literatura bazë, ndihmëse dhe e rekomanduar është relativisht e paazhurnuar; në disa raste mungon viti i publikimit, veçanërisht për ciklet e leksioneve që shërbejnë si literaturë bazë.</i></p> <p><i>Në këtë kontekst, GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve për të përfshirë literaturë bashkëkohore, bazë dhe ndihmëse, duke pasur parasysh zhvillimet dinamike të njohurive të përfshira në lëndët e programit dhe literaturën bashkëkohore në dispozicion. Për më tepër, sygjerohet që literatura e përzgjedhur të jetë e përshtatshme dhe përfaqësuese për disiplinën përkatëse dhe të përmbajë burime të reja të pesë viteve të fundit, në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky proces do të sigurojë një përditësim të vazhdueshëm dhe relevant të përmbajtjes së programit dhe do të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies për studentët.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2023-2024; Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2024-2025; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.90_(Njoftime për studentët; Evidenca_Nr.19_(Vendim i Senatit për Riorganizimin e Programit MP Drejtim i SME-ve , 2024; Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024; VKM Nr.1161 datë 25.11.2009, për hapjen e programit të studimit të vitit 2009]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ vlerëson se:</i></p> <p><i>- programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është i strukturuar në përputhje me standardet ligjore dhe siguron një formim të integruar teoriko-profesional për studentët.</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>-Megjithatë, niveli i aktivizimit të studentëve dhe peshës së vlerësimit semestral duhet të ketë një përfaqësim më të madh në vlerësimin total, për të nxitur motivimin dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve.</i></p> <p><i>-Literatura e përdorur në syllabuse është pjesërisht e paazhurnuar dhe, në disa raste, mungon viti i publikimit, kryesisht të ciklet e leksioneve që shërbejnë si literaturë bazë. GVJ rekomandon rritjen e peshës së vlerësimit semestral dhe përfshirjen e detyrave individuale dhe të grupit, si dhe rishikimin e syllabuseve për të përfshirë literaturë bashkëkohore, bazë dhe ndihmëse, me referenca të përfaqësuara dhe burime të publikuara gjatë pesë viteve të fundit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> | <p>Lëndët që janë përfshirë më planin mësimor të Master Profesional “Drejtim i SME-ve”, janë lëndë të cilat ofrojnë njohuri në këtë fushë studimi. Emërtimi i lëndëve është në harmoni me përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve. Përmbajtja e lëndëve ofron njohuri të drejtimit të biznesit të nevojshme për arritjen e kompetencave të synuara të studentëve.</p> <p>Në këtë program studimi mundësohen njohuri edhe në drejtime të tjera të shkencës së ekonomisë duke mundësuar njohuri dhe kompetenca ndërdisiplinore. Programi i studimit ka në përmbajtje Praktikën profesionale, e rëndësishme për kompetenca profesionale që të lehtësojnë përshtatjen e studentëve në tregun e punës.</p> <p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim të SME-ve” ka nevojë për një rishikim të planit mësimor, me qëllim rritjen e koherencës ndërmjet emërtimit të programit, përmbajtjes së tij dhe kompetencave që ai synon të zhvillojë. Lidhja ndërmjet titullit të programit dhe strukturës së</i></p> |

kurrikulës sygjerohet të jetë më e plotë, në mënyrë që të forcojë qartësinë e profilit profesional dhe orientimin praktik që programi ofron për studentët.

Konstatohet se programi është riorganizuar në masën nën 20%, megjithatë, ndryshimi i evidentuar lidhet vetëm me një korrektim terminologjik të një lënde – nga “Drejtim i avancuar projekti” në “Drejtim i avancuar i projekteve” – pa ndryshime përmbajtësore apo ndikim real në strukturën akademike të programit.

Në këtë drejtim, GVJ sugjeron që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e riorganizimit të programit (nën 20%) për të pasuruar kurrikulën me lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje që lidhen drejtpërdrejtë me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto lëndë do të mundësonin zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve në fusha kyçe si: sipërmarrja inovative, financimi dhe zhvillimi i SME-ve, strategjitë e rritjes së bizneseve, menaxhimi i qëndrueshëm, sipërmarrja digjitale, sipërmarrja sociale dhe inovacioni në modelet e biznesit. Një riorganizim i tillë do ta bënte programin më të fokusuar në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse për menaxhimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, më të përshtatshëm ndaj kërkesave të tregut të punës dhe më konkurrues në tregun e studimeve pasuniversitare.

Duke u mbështetur në kurrikulat bashkëkohore të universiteteve prestigjioze ndërkombëtare në fushën e sipërmarrjes dhe menaxhimit të SME-ve, GVJ rekomandon që institucioni të analizojë, rishikojë dhe përshtatë planin mesimor, me qëllim integrimin e lëndëve që i japin programit një profil më të qartë sipërmarrës dhe një orientim më të fortë drejt zhvillimit të aftësive praktike dhe profesionale të studentëve në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.


[Referenca: Evidenca_Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Menaxhim Biznes, V.A. 2023-2024; Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Menaxhim Biznes, V.A. 2024-2025; Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Menaxhim Biznes]

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p> | <p>Programi i studimit Master Profesional në “ Drejtim i SME-ve”, zhvillohet në 1 (një) vit akademik me një total prej 60 kreditesh ECTS. Në syllabuse jepet informacion për temat që do të zhvillohen dhe objektivat e lëndës. Programi i studimit jep informacion për orët që zhvillohen në leksione dhe seminare, brenda dhe jashtë auditorit, detyrimet për çdo modul si dhe kreditet, ku çdo lëndë ka kreditet e percaktuara ECTS, përfshirë Praktikën profesionale dhe Mikrotezën. Shpërndarja e lëndëve, vlerësimi në kredite dhe orët mësimore të zhvilluar mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit</p> <p><i>[Referenca: Evidenca Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2023-2024; Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2024-2025; Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> | <p>Struktura e programit është e ndërtuar që mësimi të zhvillohet brenda një viti dhe studentët të kenë mundësi të ushtrojnë profesionin. Lëndët kanë nga 5-7 kredite ECTS, dhe kanë të percaktuar ngarkesën leksione dhe seminar në auditor nga 25-50 orë, si dhe orët e punës individuale jashtë auditorit nga 65-100 orë. Plani mësimor ne total permban 1500 orë.</p> <p>Format kryesore e mësimdhënies në programin e studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” janë leksionet dhe seminarat.</p> <p>Emërtimet e lëndëve janë në përputhje me përmbajtjen e syllabuseve dhe reflektojnë temat dhe kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë. Përmbajtja e tyre siguron një formim të integruar teorik dhe praktik në fushën e sipërmarrjes së NVM-ve, duke kontribuar në arritjen e kompetencave të synuara të studentëve.</p> <p>Programi ofron gjithashtu njohuri në fusha të tjera të shkencës së ekonomisë, duke krijuar mundësi për zhvillimin e kompetencave ndërdisiplinore. Përfshirja e praktikës profesionale në strukturën e programit përbën një komponent thelbësor për zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve, duke lehtësuar integrimin e tyre në tregun e punës.</p> <p>Lëndët e përfshira në planin mësimor të programit Master Profesional “Drejtim i SME-ve” ofrojnë njohuri në fushën e drejtimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. <i>Megjithatë,</i></p> |




| | |
|---|--|
| | <p><i>GVJ vlerëson se programi ka nevojë për një rishikim të planit mësimor, me qëllim forcimin e koherencës ndërmjet emërimit të programit, përmbajtjes së tij dhe kompetencave që synon të zhvillojë. Lidhja më e qartë ndërmjet titullit të programit dhe strukturës së kurrikulës do të forconte profilin profesional dhe orientimin praktik të tij, duke e bërë programin më tërheqës dhe më të përshtatur me nevojat reale të tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e rishikimit të programit në nivelin 20%, duke përfshirë lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje që lidhen ngushtë me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të SME-ve. Kjo do të rrisë specializimin, praktikën dhe konkurrueshmërinë e programit, duke siguruar një koherencë të plotë mes emërimit të tij dhe përmbajtjes akademike.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024; VKM Nr.1161 datë 25.11.2009, për hapjen e programit të studimit të vitit 2009; Evidenca_Nr.18_(Vendimi për Hapjen e Programit të Studimit MP Drejtim i SME-ve Viti 2009; Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve)</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Lëndët që janë në përbërje të programit të studimit i shërbejnë arritjes së objektivave formuese, transferimit të studimeve si dhe mobilitetëve. Lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Menaxhim Biznes Viti 2024; VKM Nr.1161 datë 25.11.2009, për hapjen e programit të studimit të vitit 2009; Evidenca_Nr.18_(Vendimi për Hapjen e Programit të Studimit MP Menaxhim Biznes Viti 2009; Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Menaxhim Biznes]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për</p> | <p>Shqyrtimi i syllabuseve tregon se literatura bazë, ndihmëse dhe e rekomanduar është relativisht e paazhornuar; në disa raste mungon viti i publikimit, veçanërisht për ciklet e leksioneve që shërbejnë si literaturë bazë.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> | <p><i>GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve për të përfshirë literaturë bashkëkohore, bazë dhe ndihmëse, duke pasur parasysh zhvillimet dinamike të njohurive të përfshira në lëndët e programit dhe literaturën bashkëkohore në dispozicion. Për më tepër, sugjerohet që literatura e përzgjedhur të jetë e përshtatshme dhe përfaqësuese për disipinën përkatëse dhe të përmbajë burime të reja të pesë viteve të fundit, në përputhje me bazën ligjore dhe nenligjore në fuqi. Ky proces do të sigurojë një përditësim të vazhdueshëm dhe relevant të përmbajtjes së programit dhe do të rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies për studentët.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2023-2024; Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2024-2025)]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> | <p>GVJ konstaton se plani mësimor i programit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” krijon mundësi reale për përfitimn e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara, në përputhje me objektivat e përcaktuara të programit. <i>Megjithatë, GVJ vlerëson se programi ka nevojë për një rishikim të planit mësimor, me qëllim forcimin e koherencës ndërmjet emërtimit të programit, përmbajtjes së tij dhe kompetencave që synon të zhvillojë. Lidhja më e qartë ndërmjet titullit të programit dhe strukturës së kurrikulës do të forconte profilin profesional dhe orientimin praktik të tij, në fushën e sipërmarrjes së vogël dhe të mesme, duke e bërë programin më tërheqës dhe më të përshtatur me nevojat reale të tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e rishikimit të programit në nivelin 20%, duke përfshirë lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje që lidhen ngushtë me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të SME-ve. Kjo do të rrisë specializimin, praktikën dhe konkurrueshmërinë e programit, duke siguruar një koherencë të plotë mes emërtimit të tij dhe përmbajtjes akademike të tij.</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve</p> | <p>GVJ vlerëson se lëndët kryesore të programit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, mundësojnë zhvillimin e kompetencave të nevojshme dhe rritjen e mundësive të punësimit në fushën e drejtimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të</p> |

| | |
|--|--|
| <p>dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>mesme. Programi ofron njohuri bashkëkohore dhe praktike që i lejojnë studentët të operojnë me efikasitet në një ekonomi dinamike kombëtare dhe ndërkombëtare, duke thelluar njohuritë e fituara në nivelin Bachelor dhe duke i përgatitur për tregun konkurrues të punës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.23_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2023-2024; Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve , V.A. 2024-2025; Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve)</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ vlerëson se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është konceptuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe ofron një bazë të mirë teorike dhe praktike për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve.</i> - <i>Programi është i strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojë formim të avancuar dhe ndërdisiplinor, me një shpërndarje të arsyeshme të krediteve dhe ngarkesës mësimore, si dhe me përfshirjen e praktikës profesionale që lehtëson integrimin në tregun e punës.</i> - <i>Megjithatë, GVJ konstaton nevojën për azhornimin e literaturës bazë dhe ndihmëse në syllabuse, duke përfshirë burime bashkëkohore dhe të përditësuara të pesë viteve të fundit, për të reflektuar zhvillimet e reja në fushën e menaxhimit.</i> - <i>GVJ vlerëson se programi ka nevojë për një rishikim të planit mësimor, me qëllim forcimin e koherencës ndërmjet emërimit, përmbajtjes dhe kompetencave që synon të zhvillojë. Një lidhje më e qartë ndërmjet titullit dhe strukturës së kurrikulës do të forconte profilin profesional dhe orientimin praktik, duke e bërë programin më tërheqës dhe më të përshtatur me nevojat reale të tregut të punës.</i> - <i>GVJ rekomandon që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e rishikimit në nivelin 20%, duke përfshirë lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje që lidhen ngushtë me drejtimin dhe menaxhimin e SME-ve. Kjo do të rrisë specializimin, aspektin praktik dhe konkurrueshmërinë e programit, duke siguruar koherencë të plotë mes emërimit dhe përmbajtjes akademike.</i> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X | |

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> | <p>GVJ konstaton se drejtuesit e institucionit, duke përfshirë, Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, stimulojnë dhe mbështesin angazhimin e personelit akademik dhe studentëve në projekte dhe aktivitete kërkimore. GVJ vlerëson se kjo qasje ka krijuar një mjedis pozitiv për përfshirje aktive në aktivitetet shkencore, duke nxitur bashkëpunim ndërdisiplinor dhe zhvillim profesional të pjesëmarrësve.</p> <p>Nevojat e tregut të punës identifikohen nga konsultimet me partnerët e institucionit, dhe punëdhënësit e studentëve të punësuar. Institucioni kryen një anketë për Alumnin ku ndër të tjera studentët Alumni komentojnë për përmirësimin e programit. Institucioni organizon pyetësor për punëdhënësit e studentëve të diplomuar ku tërheq mendimet tyre në lidhje me përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve ; Evidenca_Nr.20_(Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024; Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve)</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> | <p>Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësori anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre. Në Statut është e përcaktuar që studentët janë të përfshirë në disa organe të institucionit si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre. Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, prej të cilëve merr informacion në lidhje me punësimin e tyre, kërkesat e tregut të punës duke mundur edhe të kuptuarit e nevojës për ndryshim të programit.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.33_(Model_Pyetësori_për_Studentët_e_Diplomuar; Evidenca_Nr.40_(Studimi_i_Tregut_të_Punës_për_Master_Profesional_në_Drejtim_i_SME-ve; Evidenca_Nr.49_(Tabelë_Përmbledhëse_me_Aktivitete_të_Zhvilluara_nga_Lektori_për_Vitet_2023-2025; Evidenca_Nr.50_(Analiza_Vjetore_e_FB_2023-2024; Evidenca_Nr.50.1_(Aktivitetet_mësimore-shkencore_në_FB_për_2024-2025; Evidenca_Nr.51_(Buletini_i_Aktiviteteve_në_Departamentin_e_Menaxhimit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p> | <p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është hartuar në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar dhe synon të pajisë studentët me njohuri dhe kompetenca profesionale për menaxhimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Megjithatë, GVJ vlerëson se aktualisht ekziston një mospërputhje mes emërtimit të programit dhe strukturës së kurrikulës, e cila redukton qartësinë e profilit profesional dhe orientimin praktik të tij.</p> <p><i>GVJ sygjeron që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e rishikimit të programit nën nivelin 20%, duke përfshirë lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje që lidhen ngushtë me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të SME-ve. Ky rishikim do të rrisë koherencën ndërmjet emërtimit dhe përmbajtjes së programit, do të forcojë specializimin dhe orientimin praktik të studentëve, dhe do ta bëjë programin më konkurrues dhe të përshtatshëm për tregun e punës.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon gjithashtu që gjatë këtij procesi institucioni të konsultohet me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private, për të siguruar që kurrikula e re reflekton nevojat reale të tregut dhe trendet bashkëkohore në fushën e menaxhimit të SME-ve.</i></p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.65_(Njoftime_për_punësim_të_studentëve_dhe_alumnit; Evidenca_Nr.71_(Të_Dhëna nga_Spektori_i_Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit; Evidenca_Nr.69_(Karriera_dhe_Alumni_UAMD, Kalendari_i_aktiviteteve_dhe_trajnimet; Evidenca_Nr.5_(Plani_i_Zhvillimit_Strategjik_të_Programit_-_MP_Drejtim_i_SME-ve; Evidenca_Nr.17_(Analiza_për_Programin_e_Studimit_Master_Profesional_Drejtim_i_SME-ve)]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>- Programi Master Profesional në Drejtim i SME-ve, është i hartuar në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar dhe synon të pajisë studentët me njohuri dhe kompetenca profesionale për tregun e punës.</p> <p>- Drejtuesit dhe stafi akademik nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe personelit në projekte dhe kërkime shkencore, duke krijuar një mjedis për zhvillim profesional dhe bashkëpunim ndërdisiplinor.</p> <p>- GVJ rekomandon që institucioni të shfrytëzojë mundësinë e rishikimit të programit nën nivelin 20%, duke përfshirë lëndë karakterizuese dhe/ose me zgjedhje të lidhura ngushtë me drejtimin dhe menaxhimin e SME-ve. Për të siguruar që kurrikula e rishikuar reflekton nevojat reale të tregut dhe trendet bashkëkohore në menaxhimin e SME-ve, GVJ sugjeron që institucioni të konsultohet me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p> | <p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” përmban lëndë që pasqyrojnë profilin dhe qëllimin e programit. GVJ vlerëson se syllabuset përfshijnë objektivat dhe rezultatet e pritshme të të nxënit, të cilat janë në përputhje me qëllimet institucionale dhe me kërkesat e tregut të punës në një shoqëri në zhvillim të vazhdueshëm. Gjithashtu, GVJ vlerëson se caktimi i koordinatorit të programit me detyra dhe përgjegjësi të qarta siguron monitorim dhe menaxhim efektiv të zbatimit të programit, duke garantuar përputhshmëri me objektivat e përcaktuara akademike dhe profesionale.</p> <p>[Referenca: Evidenca Nr.40 (Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve); Evidenca Nr.20 (Riorganizimi MP Drejtim i SME-ve Viti 2024); Evidenca Nr.17 (Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve)]</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit përbën njësinë bazë akademike përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore në kuadër të Fakultetit të Biznesit. Ai garanton mbarëvajtjen e programeve të studimit, zbatimin e standardeve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimin e aktiviteteve akademike në përputhje me kërkesat statutorë të institucionit. GVJ vlerëson se liria akademike është e garantuar, në përputhje me Statutin e universitetit, përmes të drejtës së stafit akademik për të organizuar veprimtari mësimore dhe kërkimore, për të zhvilluar programe studimi dhe për të përcaktuar fushat prioritare të kërkimit shkencor. Gjithashtu, GVJ vëren se Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore, luan rol kyç në bashkërendimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke siguruar koherencë midis objektivave akademike dhe zhvillimit të programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.37.3_(Lista e Marrëveshjeve për Mobilitete, Evidenca_Nr.18_(Rregullore e Organizimit të Konferencave dhe Veprimtarive Shkencore në UAMD; Evidenca_Nr.47_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën e FB; Evidenca_Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën Studentore)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p> | <p>GVJ mendon se numri relativisht i ulët i studentëve krijon mundësi për përfshirje të tyre në proceset akademike dhe institucionale. GVJ vlerëson pozitivisht faktin se studentët janë të përfaqësuar në organet kryesore vendimmarrëse të institucionit, si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i ceshtjeve studentore, Komisioni i Kurrikulave si dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, duke u mundësuar atyre të shprehin mendimin dhe të kontribuojnë në proceset e përmirësimit institucional. Gjithashtu, GVJ vlerëson se marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm për zhvillimin e praktikës profesionale dhe mundësitë e punësimit për studentët përbëjnë një element të rëndësishëm që lidh programin e studimit me tregun e punës dhe fuqizon komponentin praktik të formimit profesional.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.22_(Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore; Evidenca_Nr.47_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën e FB; Evidenca_Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën</i></p> |

| | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | <i>Studentore; Evidenca_Nr.50.1_(Aktivitetet mësimore-shkencore në FB për 2024-2025; Evidenca_Nr.49_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2023-2025; Evidenca_Nr.51_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit]</i> | | | |
| Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit zhvillon aktivitete akademike dhe kërkimore, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së formimit profesional të studentëve dhe në forcimin e profilit akademik të stafit akademik. Çdo vit, departamenti organizon vizita studimore pranë bizneseve, leksione të hapura dhe aktivitete shkencore, duke krijuar ura bashkëpunimi midis universitetit dhe sektorit real të ekonomisë. GVJ vlerëson se mbështetja institucionale dhe financiare e UAMD-së për këto iniciativa përbën një tregues të angazhimit të universitetit në promovimin e kërkimit aplikativ, zhvillimin profesional të stafit dhe përfshirjen aktive të studentëve në veprimtari me karakter praktik e shkencor. <i>[Referenca: Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2023-2025; Evidenca_Nr.51_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit]</i> | | | |
| Konkluzione | GVJ konstaton se: - programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” garanton një orientim të qartë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardin. - programi përmban lëndë që reflektojnë profilin akademik dhe profesional të fushës së menaxhimit, me objektiva dhe rezultate të të nxënit të përshtatura me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore të disiplinës. GVJ vlerëson se Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë akademike, luan rol thelbësor në koordinimin e procesit mësimor dhe kërkimor, duke nxitur përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte, konferenca dhe aktivitete shkencore. Këto nisma, të mbështetura institucionalisht dhe financiarisht nga UAMD, kontribuojnë në zhvillimin e kulturës kërkimore dhe në forcimin e lidhjes midis studimit teorik dhe praktikës profesionale. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

| Standardi II.7 | |
|---|---|
| Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> | <p>GVJ vlerëson se Departamenti i Menaxhimit ka bashkëpunime akademike dhe kërkimore, me institucione kërkimore vendase dhe të huaja, në kuadër të bashkëpunimit institucional. Këto bashkëpunime përfshijnë jo vetëm aspektin mësimor, por edhe aktivitetet me karakter shkencor, duke mundësuar përfshirjen aktive të stafit akademik në projekte dhe iniciativa studimore. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit dhe UAMD mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen në konferenca, seminare dhe workshop-e, duke krijuar mundësi për shkëmbim njohurish, përmirësim të praktikës akademike dhe avancim të kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë, programi siguron orientim të qartë dhe të qëndrueshëm në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe në rritjen e kapaciteteve kërkimore të pjesëmarrësve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.2_ (Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidenca_Nr.28_ (Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2022-2024) Evidenca_Nr.58_ (Pjesëmarrja e Lektorëve në Projekte në FB dhe UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> | <p>Departamenti i Menaxhimit është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit. Departamenti është përgjegjës për mbarrëvajtjen e programeve të studimit që ofron dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë në programet e ofruara. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore – shkencore.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.80_ (Viti Sabatik për Personelin Akademik; Evidenca_Nr.6_ (Rregullore e UAMD; Evidenca_Nr.22_ (Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore; Evidenca_Nr.58_ (Pjesëmarrja e Lektorëve në Projekte në FB dhe UAMD; Evidenca_Nr.47_ (Vendime për Grupet e Punës në Konferencën</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>e FB; Evidenca_Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën Studentore]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> | <p>GVJ vlerëson se Fakulteti i Biznesit mbështet në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet kërkimore të studentëve, përmes organizimit të konferencës studentore vjetore, e cila shërben si një platformë për nxitjen e mendimit kritik dhe prezantimin e punimeve shkencore. Po ashtu, vizitat studimore dhe kërkimore pranë bizneseve të ndryshme, të organizuara nga stafi i Departamentit të Menaxhimit, konsiderohen si një praktikë e mirë që forcon lidhjen midis teorisë dhe praktikës profesionale.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.44_(Të Dhëna për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit;- Evidenca_Nr.47_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën e FB; Evidenca_Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën Studentore; Evidenca_Nr.50.1_(Aktivitetet mësimore-shkencore në FB për 2024-2025; Evidenca_Nr.49_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektori për Vitet 2023-2025; Evidenca_Nr.51_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit;Evidenca_Nr.22_(Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> | <p>GVJ vlerëson se programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, është i strukturuar në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik, si në nivel lokal ashtu edhe kombëtar, duke siguruar që studentët të fitojnë njohuri dhe kompetenca që mbështesin menaxhimin efektiv të bizneseve.</p> <p>GVJ konstaton se programi respekton kuadrin ligjor dhe standardet për profilet akademike dhe profesionale, duke siguruar një përputhje të qartë midis përmbajtjes së lëndëve, nivelit të studimeve dhe kërkesave të tregut. Objektivat e programit garantojnë koherencë mes strategjisë institucionale dhe formimit profesional.</p> <p>Në këtë kuadër, GVJ vlerëson se programi kontribuon në formimin e profesionistëve konkurrues, të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.92_(Histori Suksesi Alumni;</i></p> |

| | | | | |
|---|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | <i>Evidenca_Nr.69_(Karriera dhe Alumni UAMD, Kalendari i aktiviteteve dhe trajnimet; Evidenca_Nr.48_(Analiza e tregut të punës MSH Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.65_(Njoftime për punësim të studentëve dhe alumnit; Evidenca_Nr.78_(Panairi i Punës; Evidenca_Nr.64.1_(Raporti i Panairit të Punës 2025]</i> | | | |
| Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | N/A | | | |
| Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>). | N/A | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ vlerëson se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti i Biznesit zhvillojnë bashkëpunime akademike dhe kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë aktivitete mësimore, konferenca, seminare dhe workshop-e, të cilat forcojnë lidhjen teori-praksë dhe rrisin kapacitetet kërkimore të stafit dhe studentëve.</i> - <i>Programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, është i strukturuar sipas nevojave të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar dhe siguron koherencë mes përmbajtjes së lëndëve, objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës. Në këtë mënyrë, programi kontribuon në formimin e profesionistëve konkurrues, të aftë të përgjigjen kërkesave të tregut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X | |

II. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” në UAMD, dosjes së programeve lëndore, por edhe nga konfirmimet e marra në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarët, projekte/detyrat e kursit, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, konsultime, si dhe praktika profesionale. Gjithashtu, konstatohet se institucioni nxit edhe zhvillimin e leksioneve të hapura me specialistë të fushës.</p> <p>Referuar RVB, plani mësimor i këtij programi studimi parashikon realizimin gjatë 1 viti akademik të 1'500 orëve mësimore të shpërndara si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 545 orë mësimore në auditor leksione, seminare, ushtrime & detyra kursi, praktika profesionale & diploma; dhe ▪ 955 orë punë e individuale jashtë auditorit. <p>Totali 1'500 orë</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.21_(Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; 11-13. Tabelat sipas</i></p> |

| | |
|---|--|
| | <i>rekomadimeve te GVJ_MP Drejtim i SME-ve.pdf; vizita ne institucion]</i> |
| Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | <p>Në rregulloren e programit të studimit jepen format e parashikuara të mësimin të cilat duke qënë të larmishme garantojnë transmetimin dhe përfitimn e dijeve. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, fleksibël e nxitëse për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike.</p> <p>Po kështu edhe studentët u shprehën pozitivisht për procesin mësimor duke konfirmuar ekzistencën e formave dhe mënyrave të ndryshme alternative të mësimin, sidomos formave të reja të mundësuar edhe me ndihmën e teknologjisë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e UAMD në mbështetjen e personelit akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike përmes bashkëpunimit me universitete të huaja për shkëmbime eksperience dhe trajnimeve të vazhdueshme në kuadrin e marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus+. Qëndrueshmëria e personelit akademik të Departamentit të Menaxhimit flet edhe për mbështetjen që ata gjejnë pranë UAMD.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te | <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik si edhe nga diskutimet me ta gjatë vizitës në institucion, GVJ formoi bindjen se pranë këtij programi studimi është angazhuar personel akademik i përgatitur, me grada shkencore dhe tituj akademikë, kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të rëndësishme për këtë program studimi. Gjithashtu, GVJ konstatoi përdorimin e metodave të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e</p> |

| | |
|---|--|
| <p>student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>studentëve në procesin mësimor duke kombinuar leksionet me seminarat, detyrat, rastet praktike dhe detyrat e kursit.</p> <p>Edhe në diskutimet me përfaqësues të studentëve, GVJ mori konfirmimin e mbështetjes dhe respektit reciprok që karakterizonte marrëdhënien me personelin akademik gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.84_(Orari MP Drejtim i SME-ve 2023-2025 + CV stafi akademik)_compressed.pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në UAMD studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet plotësimit periodik të pyetësorëve të vlerësimit të procesit mësimor, por edhe nëpërmjet përfaqësimit të tyre në Senatin e UAMD, Komisionet e Përheshme dhe Këshillat studentorë.</p> <p>Pyetësori i studentëve fokusohet në vlerësimin e performancës së personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie bazuar në aftësitë komunikuese, metodat e mësimdhënies, literaturën e përdorur, ndërveprimin, etikën, menaxhimin e kohës, si dhe komente apo sugjerime të tjera nga studenti. Kjo praktikë u konfirmua edhe nga studentët e programit të studimit në takimin gjatë vizitës në institucion. Pyetësori menaxhohet nga NJSBC e FB dhe rezultatet u vihen në dispozicion njëjësive bazë dhe dekanatit, në pajtim me kuadrin rregullator për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se pjesë e vlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit është edhe praktika e vlerësimit vjetor nga drejtuesja e Departamentit të Menaxhimit të secilit anëtar të departamentit bazuar në realizimin e aktivitetit mësimdhënës, kërkimor dhe administrativ, si dhe plotësimi i formularit të vetëvlerësimit dhe përditësimi i dosjeve individuale prej tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.30_(Anketimi i Studentëve në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.31_(Formulari i Vlerësimit për Pedagogët nga Studentët).pdf;</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <i>Evidenca_Nr.32_(Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut).pdf; vizita ne institucion</i> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>Në Rregulloren për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohen strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, organizimi, detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre për procesin e vlerësimin të brendshëm në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Në nivel UAMD është ngritur Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KPGSC) dhe Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) me anëtarë të përzgjedhur nga personeli akademik si dhe me përfaqësues nga studentët. Gjithashtu, pranë FB është ngritur NJBSC e fakultetit dhe Grupet e vlerësimin të brendshëm të programeve të studimit me anëtarë të përzgjedhur nga personeli akademik si dhe me përfaqësues nga studentët.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni mbështet personelin akademik në kualifikimin e vijueshëm me objektiv përmirësimin dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies përmes aplikimit në mobilitete Erasmus, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përfshirjes në projekte të ndryshme pranë UAMD.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; Info shtese 1. Evidenca_Nr.107_(Strukturat per Garantimin e Cilesise).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i procesit mësimor në UAMD është cilësor dhe garanton marrjen dhe praktikimin e njohurive në fushën e menaxhimit, në funksion të arritjes së synimeve të programit të studimit. - Procesi mësimor është i fokusuar tek studenti për të lehtësuar mësimnxënien dhe karakterizohet nga praktikatat më të mira. - Studentët përfshihen në procesin e vlerësimin të mësimdhënies. |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | - <i>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore mbështesin dhe promovojnë përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi III.2 | |
|---|---|
| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | <p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive e dijeve të studentëve përcaktohet në Rregulloren e UAMD (neni 68), e cila gjendet e publikuar në faqen zyrtare në internet të institucionit. Kjo mënyrë vlerësimi përcaktohet edhe në Rregulloren e FB dhe është e përfshirë në programet lëndore (syllabuset) të këtij programi studimi. Konkretisht, vlerësimi përfshin vlerësimin gjatë semestrit, detyrat dhe projektet e kursit si edhe vlerësimin përmes provimit të ndërmjetëm të lëndës në javën 7/8 të semestrit dhe provimit përfundimtar në fund të semestrit. Provimet janë me shkrim kurse detyrat dhe projektet e kursit prezantohen para grupit mësimor. Vlerësimi bazohet në një sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, që konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar, ku nota më e ulët kaluese është pesa që korrespondon me 51% të pikëve të fituara. Në rast riprovimi në sezonet e pasardhëse vlerësimi bazohet në një provim të vetëm me 1000 pikë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; https://uamd.edu.al/kuadri-ligjor-rregullator/; vizita ne institucion]</i></p> |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët | Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në |

| | | | | | | | |
|---|---|----------------------------|-----|--------------------------------------|-----|----------------------|-----|
| <p>informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se studentët, që në fillim të semestrit, njihen me të gjithë elementët e syllabusit përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve nga pedagogu i lëndës. Zakonisht, ora e parë e çdo lënde i rezervohet prezantimit të detajuar nga ana e pedagogut të lëndës të elementëve të lëndës si: temat, literaturën, detyrimet për frekuentimin dhe aktivizimin, si dhe metodologjinë e vlerësimit. Gjithashtu, studentët prezantohen edhe me elementët kryesorë të kuadrit rregullator të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</i></p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>GVJ, pasi shqyrtoi programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” në UAMD, vërejtë se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve si: provimet dhe testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e projektet e kursit.</p> <p>Një përmbledhje e peshës që ka çdo formë vlerësimi jepet edhe në tabelën 15 në RVB dhe GVJ konstaton se kjo formë organizimi ndiqet në çdo lëndë të programit të studimit:</p> <table border="0" data-bbox="683 1272 1295 1393"> <tr> <td>Projektet/detyrat e kursit</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm gjatë semestrit</td> <td>40%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>50%</td> </tr> </table> <p>GVJ vlerëson se përfshirja e formave të ndryshme të vlerësimit u jep mundësinë studentëve të shprehin më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara dhe shpërndarja përgjatë semestrit ndihmon monitorimin e vazhduar të ecurisë së studentëve.</p> <p>Megjithatë, si u theksua edhe më herët (kriteri 4, standardi II.3), GVJ sugjeron që vlerësimi semestral, i cili orienton drejt përgatitjes së vazhdueshme të studentëve dhe rrit aktivizimin e tyre, të ketë një peshë më të madhe sesa 10% e vlerësimit total, duke përfshirë edhe vlerësimin e detyrave individuale, e detyrave në grup apo të formave të tjera të aktivizimit gjatë semestrit përveç detyrës së kursit tashmë të parashikuar.</p> | Projektet/detyrat e kursit | 10% | Provimi i ndërmjetëm gjatë semestrit | 40% | Provimi përfundimtar | 50% |
| Projektet/detyrat e kursit | 10% | | | | | | |
| Provimi i ndërmjetëm gjatë semestrit | 40% | | | | | | |
| Provimi përfundimtar | 50% | | | | | | |



50



| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | [Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion] | | | |
| Konkluzione | GVJ konstaton se: - Kuadri rregullator i UAMD përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe vlerësimi të cilat u bëhen me dije studentëve para fillimit të lëndës. - Këto forma të ndryshme kontrolli garantojnë një shpërndarje dhe mbulim të mirë të vlerësimit të çdo studenti në këtë program studimi. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte i përfshirë në programet lëndore (syllabuset) dhe realizohej sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UAMD. Konkretisht, vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi ishte i harmonizuar dhe llogaritej sipas parashikimeve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 10% e vlerësimit nga detyrat/projektet e kursit; ▪ 40% e vlerësimit nga provimi i ndërmjetëm; si dhe ▪ 50% e vlerësimit nga provimi përfundimtar i lëndës. <p>GVJ vlerëson se format e ndryshme të testimit të njohurive, si edhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit nxit kryesisht studentët që të angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në procesin mësimor dhe i ndihmon ata në arritjen e rezultateve të larta dhe përfitimit të njohurive të plota.</p> <p>[Referenca: Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>GVJ konstaton se UAMD, si shumë universitete të tjera në vendin tonë, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro – Amerikan për Zhvillimin, për përdorimin e korrigjimit të automatizuar të provimeve përmes metodës CleanScore. Në takimin me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se përdorimi i këtij sistemi vlerësimi gjykohej i papërshtashëm për këtë program studimi pasi kufizonte lektorin në hartimin e tezave, në zgjedhjen e situatave ushtrimore, si dhe numri i ulët i studentëve në këtë program nuk justifikon kostot e përdorimit në vlerësim të një sistemi të tillë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.102_(Projekti CleanScore).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet përfundimtare zhvillohen me shkrim dhe në përputhje me kuadrin rregullator të UAMD. Vlerësimi me notë është sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me nota kaluese nga 5 deri në 10, bazuar në totalin e vlerësimeve me pikë të marra gjatë vitit dhe pikëve të marra në provimin përfundimtar.</p> <p>Në UAMD përdoret një sistem pikëzimi 0-1000 pikë, ku notës më të ulët kaluese (pesës) i korrespondojnë 51% e pikëve gjithsej. Në nenin 68 të Rregullores së UAMD dhe në nenin 59 të Rregullores së FB programit jepet një paraqitje e detajuar e tabelës së konvertimit të pikëve totale në notë. Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e çdo lënde për të rritur transparencën e komunikimit me studentët dhe të tjerë të interesuar.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me</p> | <p>GVJ konstatoi se në Rregulloren e Provimeve të FB (neni 4, pikat 7 & 9), në pajtim me kërkesat e Rregullores së UAMD (neni 69) parashikohet procedura e korrigjimit të provimeve</p> |

| | |
|---|---|
| <p>komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>(si vendosja e pikëve sipas grupeve të pyetjeve, si dhe në total dhe me ngjyrë të dallueshme nga pjesa tjetër e provimit), mënyra dhe afati i dhënies së rezultateve (ballafaqimi i studentit me fletoren e provimit duke marrë sqarimet e duhura) në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Në takimet me studentët dhe personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmin e realizimit të kësaj procedure dhe se në UAMD bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve përfundimtare, si edhe i provimeve të ndërmjetme, i detyrave/projekteve të kursit, duke u dhënë studentëve këshilla në funksion të përmirësimit të punës së tyre në të ardhmen..</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>Në Rregulloren e Provimeve në FB (neni 5) parashikohen rregullat e organizimit të provimit që synojnë eliminimin e sjelljeve të dënueshme si kopjimi në provime dhe plagjiatura në punime shkencore. Gjithashtu, kërkesat e Kodit të Etikës janë përfshirë edhe në programet lëndore (syllabuset). Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Ata u sqarojnë studentëve se çfarë përbën plagjiarizëm duke synuar formimin dhe edukimin e tyre për të ushtruar aktivitetet kërkimor dhe mësimor cilësor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.16_(Kodi i Etikës në UAMD).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Gjithashtu, në Rregulloren e Provimeve në FB (neni 5, pika 7), parashikohet procedura e komunikimit të rezultateve paraprake të provimit, ballafaqimit të studentit me fletoren e provimit dhe hedhja në sistem e rezultateve nga personeli akademik (brenda 72 orëve nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar). Sistemi ku hidhen vlerësimet është platforma</p> |




| | |
|---|---|
| | <p>Pitagora, në të cilën kanë të drejta përdorimi personeli akademik dhe të gjithë studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se kuadri rregullator kryesor i UAMD parashikon procedurat për njohjen dhe ankimimin e vlerësimit në provim nga ana e studentit, si dhe për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Konkretisht, në rast ankese studenti duhet t'i drejtohet me shkrim Dekanit të FB, i cili sipas situatës ia kalon për shqyrtim kërkesën përgjegjësit të departamentit përkatës. Përgjegjësi i departamentit vë në dijeni Lektorin e kursit dhe pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Dekani një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit, Dekani vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit.</p> <p>Në takimet me studentët dhe personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmin për njohjen dhe ndjekjen e kësaj procedure.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>Siç u përmend edhe në kriterin më sipër, përgjegjësi i departamentit që i takon ankesa, vë në dijeni lektorin e kursit dhe pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Dekani i FB një relacion shpjegues. Në bazë të këtij relacioni Dekani vendos për miratimin ose refuzimin e ankesës së studentit. Në rastin kur ankesa refuzohet, studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit.</p> <p>Në rastin kur ankesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës që realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të caktuar. Dita dhe ora se kur do mbledhet komisioni ad-hoc, caktohet nga përgjegjësit i departamentit, por jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyrohet vendimin e tij për të</p> |

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | <p>ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës dhe dokumentacioni arkivohet në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf vizita ne institucion]</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit parashikon të gjitha procedurat që lidhen me vlerësimin e studentëve, procedurën e ankimimit dhe rishikimit të vlerësimit, si edhe vlerësimin përfundimtar të studentëve. - Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. - Studentët informohen në lidhje me vlerësimin e tyre dhe të drejtën për ankimim të vlerësimit apo në rast shkeljesh. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ doli në përfundimin se programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” në UAMD synon të formojë specialistë në menaxhimin e njësive të vogla dhe të mesme. Përmes kombinimit të njohurive teorike me ato praktike, programi synon nxitjen e nismave sipërmarrëse të studentëve, si dhe aftësimi i tyre në hartimin dhe ndjekjen e projekteve sipërmarrëse dhe planeve të biznesit. Lëndët e përfshira në këtë program studimi u mundësojnë kryesisht studentëve marrjen e njohurive të thelluara në disiplina si menaxhimi i biznesit të vogël dhe të mesëm, drejtimi i avancuar i projektit, menaxhimi logjistik dhe drejtimi financiar.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Megjithatë, sic u theksua edhe më herët (fushat I dhe II), GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve” ka nevojë për një rishikim të planit mësimor, me qëllim rritjen e koherencës ndërmjet emërimit të programit, përmbajtjes së tij dhe kompetencave që ai synon të zhvillojë. Pasurimi i kurrikulës me lëndë karakterizuese ose me zgjedhje që lidhen drejtpërdrejt me fushën e drejtimit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të mundësonte zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve në fusha kyçe si: sipërmarrja inovative, financimi dhe zhvillimi i SME-ve, strategjitë e rritjes së bizneseve, menaxhimi i qëndrueshëm, sipërmarrja digjitale, sipërmarrja sociale dhe inovacioni në modelet e biznesit.</p> <p>Gjithashtu, GVJ vlerëson se misioni i këtij programi studimi, i shprehur në rregulloren përkatëse (neni 5) ka nevojë që të rishihet dhe të formulohet në mënyrë më të qartë në funksion të përgatitjes së specialistëve drejtues për njësitë e vogla dhe të mesme.</p> <p><i>Prandaj, GVJ rekomandon që institucioni të analizojë, rishikojë dhe përshtatë planin mësimor dhe rregulloren e këtij programi studimi, me qëllim integrimin e lëndëve që i japin programit një profil më të qartë sipërmarrës dhe një orientim më të fortë drejt zhvillimit dhe thellimit të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe për të garantuar pajtueshmërinë me këto objektiva.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtimit i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.9(Rregullore e Master Profesional Drejtimit i SME-ve).pdf; Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtimit i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se me përfshirjen në planin mësimor të këtij programi studimi të lëndëve si “Komunikimi virtual” dhe “Kulturë dhe etikë”, edhe pse me zgjedhje, synohet zhvillimi i aftësive të veçanta të studentëve edhe në aspekte të</p> |

| | |
|--|---|
| <p>ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>lidhura me komunikimin, etikën në biznes dhe teknologjinë e informacionit.</p> <p><i>[Referenca: Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; Evidenca_Nr.21_(Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>GVJ konstatoi se të gjitha programet lëndore të Programit të Studimit, Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” në UAMD, kanë të përfshira si një seksion të veçantë në fillim të tyre “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar. Kjo pjesë radhit përfitimet e pritshme nga çdo lëndë e programit për të mbërritur në përmbushjen e objektivave të programit të studimit, duke u fokusuar në synimet, njohuritë dhe aftësitë e kompetencat që pritet të ketë studenti në përfundim të studimeve të asaj lënde specifike.</p> <p>Gjithashtu, në takimet e zhvilluara me studentët dhe personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në përfundim të çdo lënde realizohet një seancë përmbledhëse e njohurive të marra gjatë semestrit, ku pedagogu përkatës informon studentët edhe mbi vlerësimin e vazhdueshëm, si dhe mbi strukturën e provimit dhe çështjet kryesore ku duhet të fokusohen për provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: Info shtese 5. Evidenca_Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të</p> | <p>Në takimin, gjatë vizitës në institucion, me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Eugene O’Neill . Eugene O’Neill .Drejtim i SME-ve”, GVJ konstatoi se ata ishin të angazhuar në realizimin sa më cilësor të procesit mësimor, duke mbështetur dhe nxitur diskutimet kritike të studentëve brenda kuadrit të këtij program studimi. Syllabuset, të hartuara dhe zhvilluara prej tyre, nxisin bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes detyrave/projekteve të kursit, prezantimeve të ndryshme, analizës së rasteve studimore dhe realizimit të vizitave studimore pranë bizneseve.</p> <p>Gjithashtu, praktika profesionale e parashikuar si detyrim akademik për t’u realizuar në semestrin e dytë, u mundëson</p> |

| | |
|--|---|
| <p>përshatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>studentëve të zhvillojnë aftësitë profesionale përmes zbatimit në një mjedis profesional real të njohurive teorike të marra në auditor.</p> <p>Fokusi i këtij programi studimi është zhvillimi kryesisht i aftësive profesionale sesa ato studimore dhe shkencore të përparuara, duke qenë program i ciklit të dytë profesional. Megjithatë, GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për të përfshirë studentët me projekte cilësore kërkimore apo ide innovative për të prezantuar punën e tyre në konferenca të përbashkëta ku studentët marrin pjesë pa paguar tarifa pjesëmarrjeje.</p> <p><i>[[Referenca: Info shtese 5. Evidenca Nr.24_(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025).pdf; Evidenca Nr.34_(Strategjia e Kërkimit Shkencor UAMD 2020-2025).pdf; Evidenca Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën Studentore).pdf; Evidenca Nr.103_(Studentët dhe Kërkimi Shkencor).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i këtij programi studimi ka zhvilluar leksione të hapura me profesionistë të ftuar për të folur mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të ekspertizës, si dhe me lektorë vendas dhe të huaj në kuadrin e marrëveshjeve apo projekteve të institucionit, jashtë strukturës së programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca Nr.49_(Tabelë Përmbledhëse me Aktivitete të Zhvilluara nga Lektorit për Vitet 2023-2025).pdf; Evidenca Nr.50.1_(Aktivitetet mësimore-shkencore në FB për 2024-2025).pdf; Evidenca Nr.51_(Buletini i Aktiviteteve në Departamentin e Menaxhimit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p> | <p>GVJ konstatoi se kuadri rregullator UAMD, si dhe planet e zhvillimit strategjik kanë në vëmendje të veçantë mbështetjen dhe nxitjen e studentëve për të realizuar maksimumin e potencialit të tyre. Megjithëse fokusi i këtij programi studimi është zhvillimi kryesisht i aftësive profesionale sesa ato studimore dhe shkencore të përparuara, GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për të përfshirë studentët me</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>projekte cilësore kërkimore apo ide innovative, për të prezantuar punën e tyre në konferenca të përbashkëta ku studentët marrin pjesë pa paguar tarifa pjesëmarrjeje.</p> <p>[Referenca: Evidenca_Nr.2_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025).pdf; Evidenca_Nr.5_(Plani i Zhvillimit Strategjik të Programit - MP Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.48_(Vendime për Grupet e Punës në Konferencën Studentore).pdf; Evidenca_Nr.103_(Studentët dhe Kërkimi Shkencor).pdf; vizita ne institucion]</p> | | | |
| Konkluzione | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënia në UAMD realizohet në mënyrë profesionale nga një personel akademik i kualifikuar. - Programet lëndore (syllabueset) të këtij programi studimi janë të pasura me çështje të rëndësishme për zhvillimin e studentëve por plani mësimor ka nevojë të rishikohet dhe të përditësohet, së bashku me rregulloren e këtij programi studimi. - UAMD angazhohet në avancimin e ideve inovatore të studentëve duke i mbështetur ata të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre mësimor, profesional dhe kërkimor. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| Standardi III.5 | |
|--|--|
| Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | <p>GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UAMD parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit së diplomës që vlerësohet me 10 kredite (ECTS).</p> <p>Sipas tij, studenti ka të drejtë të hyjë në sezonin më të afërt të diplomimit pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e programit mësimor para diplomimit dhe ka plotësuar pranë Sekretarisë Mësimore të FB formatet e kërkesave përkatëse, të nevojshme</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>që UAMD të mund të konfirmojë plotësimin e kushteve për diplomim si dhe dëshirën e studentit për t'u diplomuar.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se informacioni në lidhje me shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit, u vihet në dispozicion studentëve përpara fillimit të përgatitjes së tyre për diplomim.</p> <p><i>Ndërkohë nga shqyrtimi i rregullores së këtij programi studimi, GVJ konstatoi disa pasaktësi lidhur me kushtet e diplomimit të cituara në këtë dokument (neni 30, pika 1, germa a) prandaj rekomandon rishikimin e rregullores dhe sistemimin e tyre.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; https://uamd.edu.al/kuadri-ligjor-rregullator/; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>GVJ konstaton se FB ka hartuar një rregullore të posaçme për temën e diplomës në programet master, ku përcaktohet qartë procedura e zgjedhjes, udhëheqjes dhe përgatitjes për mbrojtjen e diplomës. Gjithashtu, në rregullore përcaktohen përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor dhe të studentit, struktura e punimit, si dhe mënyra e vlerësimit, dorëzimit dhe realizimit të mbrojtjes.</p> <p>Rregullorja shoqërohet me formate në ndihmë të studentit, si formulari i aplikimit për tezën e diplomës, deklaratë për udhëheqjen, formati i punimit, formati i vlerësimit nga udhëheqësi dhe formati i vlerësimit nga komisioni.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se ata konsultoheshin dhe komunikonin rregullisht me udhëheqësit e tyre.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.62_(Njoftime me e - mail Studentët e MP MB).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Kuadri rregullator i FB përcakton se diplomimi për studentët e programeve master realizohet vetëm me tezë diplome (neni 66, pika 2) prandaj ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Siç u përmend edhe më sipër, FB ka hartuar një rregullore të posaçme për temën e diplomës në programet master, ku përcaktohet qartë procedura e zgjedhjes, udhëheqjes dhe përgatitjes për mbrojtjen e diplomës. Gjithashtu, në rregullore përcaktohen përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor dhe të studentit, struktura e punimit, si dhe mënyra e vlerësimit, dorëzimit dhe realizimit të mbrojtjes. Vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë dhe raportimeve (neni 6) si dhe etikës në kërkim (neni 11). Rregullorja e tezës së diplomës dhe rregullorja e programit të studimit, theksojnë rolin e udhëheqësit në orientimin dhe ndihmën ndaj studentëve gjatë procesit të hartimit të punimit të diplomës.</p> <p>Kjo procedurë e parashikuar në rregulloret u konfirmua edhe nga personeli akademik dhe studentët, në takimet gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Referuar diskutimeve të kryera me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” në UAMD, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi mbështetjen institucionale të studentëve për kryerjen e analizave dhe hulumtimeve të nevojshme për realizimin e punimit të diplomës. Në dispozicion të studentëve janë laboratorët dhe biblioteka fizike e FB, si edhe biblioteka online U-library.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf;</i></p> |

| | |
|---|---|
| | <i>Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i> |
| Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | <p>GVJ konstaton se diplomimi në këtë program studimi realizohet kundrejt përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome para një komisioni me jo më pak se pesë anëtarë, të cilët mbajnë gradë shkencore ose dhe tituj akademikë. Komisioni propozohet nga drejtuesja e DM dhe miratohet nga Dekani i FB.</p> <p>Pas prezantimit nga ana e studentit, brenda një afati kohor jo më pak se 20 min, si dhe sqarimit të pyetjeve nga komisioni vijohet me vlerësimin me notë nga secili anëtar, sipas sistemit shqiptar të vlerësimit. Vlerësimi final llogaritet si mesatare e notave të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe pasqyrohet në procesverbalin e mbrojtjes së tezës së diplomës, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit si edhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.12_(Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | <p>GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UAMD përcakton qartë procedurat për pajisjen me diplomë. Në përfundim të studimeve në programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, pasi ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit, si dhe detyrimet financiare ndaj institucionit, studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës sipas modelit të miratuar.</p> <p>GVJ konfirmon se emërtimi dhe suplementi i diplomës janë në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studentit dhe me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Me kërkesë të studentëve vihet në dispozicion të tyre syllabusi për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit..</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Info shtese 14. Evidenca_Nr.104_(Diploma dhe Suplementi per MP Drejtim i SME-vei).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pranë sekretarisë mësimore të FB ruhet i gjithë dokumentacioni mbi studentët, në formë e dosjeve personale, edhe pas diplomimit në arkivën përkatëse bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion studentit me kërkesën e tij dhe mund të përdoret për konfirmime ndaj personave të autorizuar.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; vizita ne institucion]</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullatori UAMD parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit. Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, por rregullorja e PS ka nevojë të rishihet.</i> - <i>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.</i> - <i>Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj.</i> - <i>Pranë UAMD dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</i> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | X | |

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme</p> | <p>Sipas RVB, Departamenti i Menaxhimit (DM) në UAMD që është njësia përgjegjëse që e ofron këtë program studimi, përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse duke</p> |

| | |
|--|--|
| <p>për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p> | <p>vendosur në dispozicion të studentëve listën e Institucioneve me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Spektori i Komunikimit, Karrierës dhe Alumnit bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit (DM) për t'u mundësuar studentëve gjetjen dhe mbikëqyrjen e duhur të praktikës profesionale.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në UAMD ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë studimeve.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.37.2_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-së).pdf; Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p> | <p>NA</p> |
| <p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p> | <p><i>Në këtë kriter, GVJ po vlerëson vetëm për praktikrat profesionale dhe jo për praktikrat klinike apo stazhet, të cilat nuk kanë lidhje me programin e studimit "Master Profesional në Drejtim i SME-ve" në UAMD.</i></p> <p>Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të studimeve. Studentët duhet të kryejnë 100% të orëve të praktikës profesionale dhe duhet të respektojnë rregullat e institucionit pritës. Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale konvertohet në 6 kredite (ECTS). Gjatë procesit të praktikës studentët drejtohen nga personeli akademik i caktuar nga DM dhe personi i caktuar nga ofruesi i praktikës.</p> |

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | <p>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një raport për praktikën e kryer, si pjesë e dosjes së studentit që më pas vlerësohet nga komisioni përkatës në datën e caktuar nga Departamenti së bashku me vlerësimet nga drejtuesi personel akademik dhe drejtuesi në vendin e praktikës.</p> <p>Kjo procedurë e parashikuar për organizimin dhe supervizionin e studentit gjatë procesit të praktikës, u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita në institucion]</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Departamenti i Menaxhimit angazhohet në gjetjen e partnerëve për realizimin e praktikës profesionale së studentëve sipas profilit të programit të studimit dhe lidh marrëveshje bashkëpunimi me to.</i> - <i>Në përputhje me Planin Mësimor, praktika profesionale vlerësohet dhe konvertohet në 6 ECTS.</i> - <i>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer që mbart edhe vlerësimin nga drejtuesi në vendin e praktikës dhe që vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni përkatës.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1 | |
|---|--|
| Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</p> <p>Numri dhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitet 2023-2025 paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>për vitin akademik 2023-2024</u> janë angazhuar gjithsej 8 pedagogë, nga të cilët 6 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë (PAE) me kualifikimet: <ul style="list-style-type: none"> 1 Profesor 3 Profesor i Asociuar 2 Doktor i Shkencave <p>Personel akademik me kontratë (PAK) janë 2 pedagogë, të cilët mbajnë titullin Profesor i Asociuar. Raporti është 75% PAE dhe 25% PAK.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>për vitin akademik 2024-2025</u> janë angazhuar gjithsej 7 pedagogë, nga të cilët 5 pedagogë si personel akademik PAE me kualifikimet: <ul style="list-style-type: none"> 2 Profesor 1 Profesor i Asociuar 2 Doktor i Shkencave <p>Personel akademik me kontratë (PAK) janë 2 pedagogë, të cilët mbajnë titullin Profesor i Asociuar. Raporti është 71% PAE dhe 29% PAK.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik</p> |

që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.

| Tituj/ grada | 2023-2024 | | 2024-2025 | |
|---------------|-----------|----------|-----------|----------|
| | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 1 | - | 2 | - |
| Prof. Asoc. | 3 | 2 | 1 | 2 |
| Dr./PhD. | 2 | - | 2 | - |
| Msc. | - | - | - | - |
| Totali | 6 | 2 | 5 | 2 |

[Referenca: Evidenca_Nr.44_(Të Dhëna për Kualifikimin dhe Kërkimin Shkencor për Anëtarët e Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.82_(Vendim datë 09.02.2018 mbi Fushat Kërkimore Shkencore për Departamentin e Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.84_(Orari MP Drejtim i SME-ve 2023-2025 + CV stafi akademik)_compressed.pdf; Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MP_MB.pdf; vizita në institucion]

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.
Për vitet akademike 2023-2025, mbi 85% e ngarkesës mësimore në këtë program studimi është mbuluar nga pedagogë personel akademik efektiv (PAE). Gjithashtu, mesatarisht 65% e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi mbajnë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar.
GVJ konstaton një ngarkesë totale të personelit akademik mbi normën e parashikuar sipas nivelit të kualifikimit, por brenda parashikimeve të mbingarkesës së lejuar sipas kuadrit rregullator në fuqi që merr parasysh numrin maksimal të lëndëve që mund të mbulojë një pedagog dhe orët suplementare për efekt pagese (praktikë tashmë karakteristike e IAL-ve publike).

[Referenca: Evidenca_Nr.84_(Orari MP Drejtim i SME-ve 2023-2025 + CV stafi akademik)_compressed.pdf; Tabelat

| | |
|---|--|
| | <i>permbledhese per Aneks _ RVB _ MP _ MB.pdf; vizita në institucion]</i> |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë Departamentit të Menaxhimit, si dhe punësimin e tyre pranë UAMD në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi një qëndrueshmëri relative të personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” me ndryshime kryesisht në kategorinë e PAK.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.56_(Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Departamentin e Menaxhimit dhe në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UAMD përcakton qartë procedurën dhe kriteret që ndiqen për vlerësimin e kandidatëve përmes konkurrimit, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit <i>ad hoc</i> që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Kriteret specifike të rekrutimit propozohen nga departamenti përkatës, miratohen nga Dekani i FB dhe i përcillen Rektorit për miratim. I gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe informacioni përkatës publikohet në faqen zyrtare në internet të UAMD dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.87.1_(Procedura për Rekrutimin e Stafit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e | <p>GVJ vlerëson përpjekjet e UAMD për të angazhuar personel ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të tjera, pjesë të programit mësimor, në përputhje me burimet në dispozicion.</p> <p>Aktualisht pranë FB janë të punësuar 2 persona si specialistë të teknologjisë së informacionit, të angazhuar në aktivitete</p> |

| | |
|--|---|
| <p>orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>administrative dhe mirëmbajtje të laboratorëve dhe ambienteve mësimore.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të përditësuara për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”. Gjatë takimit me përfaqësueset e Sektorit të Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se kjo strukturë plotëson, ruan dhe përditëson të dhënat mbi anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron UAMD në formën e dosjeve personale të personelit. Në mënyrë rastësore, GVJ shqyrtoi dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit (një me kohë të plotë dhe një me kontratë) dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, kontrata e punës, diplomatat dhe kualifikimet, librezat shëndetësore etj.</p> <p>Gjithashtu, çdo vit personeli akademik plotëson formularët e vetëvlerësimit mbi ecurinë e kërkimit shkencor dhe mësimor, që shërben për vlerësimin e performancës nga drejtuesja e departamentit dhe bëhen pjesë e analizës vjetore të punës së departamentit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza_Vjetore_e_Departamentit_të_Menaxhimit_2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.32_(Modele_për_Vlerësimin_e_Performancës_së_Pedagogut).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen</p> | <p>GVJ konstatoi se në nivel njësie kryesore janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione dhe organizata për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, e parashikuar në programin e studimit. Në pajtim me parashikimet në rregulloret përkatëse (të Tezës së Diplomës Master dhe të Praktikës) të Fakultetit të Biznesit, përgjegjësja e departamentit të Menaxhimit organizon procesin e caktimit të pedagogëve përgjegjës për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës dhe në procesin e hartimit të punimit</p> |

| | |
|---|--|
| <p>e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>të diplomës, si dhe monitoron procesin deri në vlerësimin e këtyre disiplinave me notë. Pedagogët udhëheqës të propozuar miratohen nga Dekani i FB.</p> <p>Spektori i Komunikimit, Karrierës dhe Alumnit bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit për t'u mundësuar studentëve gjetjen dhe mbikëqyrjen e duhur të praktikës profesionale.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.14_(Rregullore e Tezës së Diplomës Master në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.36_(Shembull praktike MP Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, ata konfirmuan se institucioni u kishte ofruar mbështetje për gjetjen e vendit të praktikës, megjithëse shumica e kishte gjetur vetë, pasi ishin të punësuar që gjatë studimeve. Rregullorja e Praktikës e Fakultetit të Biznesit, me elementët e saj shoqëruar si formulari i vlerësimit nga pedagogu udhëheqës, vërtetimi i konfirmimit nga institucioni pritës dhe formati i raportit të praktikës, i mundëson edhe personelit mbikëqyrës në ambientin pritës të praktikës që të ndihmojnë studentët në realizimin e sukseshëm të saj dhe të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.15_(Rregullore e Praktikës Profesionale në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.36_(Shembull praktike MP Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.37_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi ka nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programe studimi Master. - Personeli akademik efektiv i DM dhe ai i angazhuar në këtë program studimi është i qëndrueshëm. |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Pranë FB angazhohet personel ndihmës i përshtatshëm për realizimin e aktiviteve ndihmëse të procesit akademik. - Sektori i Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë. - FB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | |
|--|--|---------------------|--------------------|----------------|----|--|----|-----------------------------------|---|------------|---|-----------------------------------|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” e zhvillon procesin mësimor pranë mjedisve të Fakultetit të Biznesit (FB), Godina nr.2 në Kampusin Universitar në Spitalë.</p> <p>Përmbledhtas të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë FB paraqiten si vijon:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FB</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Zyra – Personeli akademik/ departamentet</td> <td>24</td> </tr> <tr> <td>Laboratorë informatike & të tjera</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Sekretaria</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë / salla për aktivitete</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> | Mjedisi - FB | Nr. Sallash | Salla leksioni | 17 | Zyra – Personeli akademik/ departamentet | 24 | Laboratorë informatike & të tjera | 4 | Sekretaria | 3 | Bibliotekë / salla për aktivitete | 2 |
| Mjedisi - FB | Nr. Sallash | | | | | | | | | | | | |
| Salla leksioni | 17 | | | | | | | | | | | | |
| Zyra – Personeli akademik/ departamentet | 24 | | | | | | | | | | | | |
| Laboratorë informatike & të tjera | 4 | | | | | | | | | | | | |
| Sekretaria | 3 | | | | | | | | | | | | |
| Bibliotekë / salla për aktivitete | 2 | | | | | | | | | | | | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | <p>Ambiente ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zyre informacioni ▪ Mjedise sherbimi ▪ Zyra të tjera (financa, it, studentët) | 5 | |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset mësimore dhe zyrat e personelit akademik në Godinën 2 të Fakultetit të Biznesit janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve. Sallat e leksionit dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë (të lëvizshëm), tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.79_(Infrastruktura).pdf; Evidenca_Nr.84_(Orari MP Drejtim i SME-ve 2023-2025 + CV stafi akademik) compressed.pdf; Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MP_MB.pdf; vizita në institucion]</i></p> | | |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësisimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p> | <p>Programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon orë të detyrueshme laboratorike. Megjithatë, Fakulteti i Biznesit disponon katër laboratorë të pajisur me videoprojektorë (të lëvizshëm), tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet që mund të përdoren edhe nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.79_(Infrastruktura).pdf;</i></p> | | |

| | |
|--|---|
| programit të studimit në tërësi. | <i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MP_MB.pdf; vizita në institucion]</i> |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se, megjithëse programi i studimit nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar, studentët pranë Fakultetit të Biznesit kanë në dispozicion katër laboratorë (dy informatike dhe dy për lëndët) që mund t'i përdorin për realizimin e detyrave të kursit, përgatitjen e temës së diplomës, apo për aftësimin e pavaruar individual në funksion të nevojave të programit të studimit. <i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.79_(Infrastruktura).pdf; Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MP_MB.pdf; vizita në institucion]</i> |
| Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme. | NA |
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> - UAMD ka ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore. - Sallat e leksioneve, laboratorët dhe ambientet e tjera në Godinën 2, në dispozicion të Fakultetit të Biznesit, janë të |

73

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një proces mësimor bashkëkohor.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi IV.3 | |
| Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme). | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar të RVB, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e rekomanduar në syllabuset e programit të studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” është në përputhje me nevojat për dije dhe njohuri të parashikuara për studentët e ciklit master.</p> <p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.24(Syllabuset në Master Profesional në Drejtim i SME-ve, V.A. 2024-2025.pdf; Evidenca_Nr.43(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | <p>Në takimin me personelin akademik, GVJ mori konfirmimin se, në fillim të çdo viti akademik, pedagogët bëjnë rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe secili departament paraqet propozimin për listën e librave të nevojshëm për procesin mësimor dhe që duhet t’i shtohen fondit të bibliotekës.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.43(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit).pdf; Evidenca_Nr.76_(Proçedura për Pasurimin e Literaturës në Bibliotekë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD vë në dispozicion të gjithë studentëve dhe stafit të tij, bibliotekën e të organizuar me disa ambiente dhe që funksionojnë kundrejt anëtarësimit me kartelë regjistrimi.</p> <p>Në Kampusin Universitar të UAMD, pranë Godinës 1 gjendet Biblioteka Nr. 2 (me sip. 220 m²) dhe pranë Godinës nr. 2 ndodhet një sallë leximi me vende për studim, lidhje interneti wi-fi dhe vende pune të pajisura me kompjutera për shfrytëzimin e burimeve online. Ambientet e bibliotekës mund të shfrytëzohen njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.70_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike).pdf; https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme, por edhe tituj elektronikë në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UAMD si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.43(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit).pdf; Evidenca_Nr.57(Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore).pdf; Evidenca_Nr.67(Manual Biblioteka Online).pdf; Evidenca_Nr.68(Biblioteka Online-Të dhëna mbi materialet e disponueshme).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në disa biblioteka dhe platforma online si U-Library, JSTOR, COBISS, etj., si dhe në arshivën e librit elektronik të UAMD.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.57(Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore).pdf;</i></p> |

75

| | |
|--|---|
| | <i>Evidenca_Nr.67(Manual Biblioteka Online).pdf; vizita në institucion]</i> |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | <p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në disa biblioteka dhe platforma online si U-Library, JSTOR, COBISS, etj., si dhe në arshivën e librit elektronik të UAMD.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme (kompjuteri, videoprojektorë, lidhje wi-fi) që mund të shfrytëzohet nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.57(Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore).pdf; Evidenca_Nr.67(Manual Biblioteka Online).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | <p>GVJ konstatoi se biblioteka është në shërbim të studentëve çdo ditë të javës, përfshirë edhe fundjavën. Për t'u ardhur në ndihmë nevojave të studentëve është krijuar arshiva akademike-bibliografi online, si dhe një hapësirë e dedikuar në faqen zyrtare të internetit të UAMD që përditësohet me informacione mbi bibliotekën dhe aktivitetin e saj.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.100(Kalendari i Funksionimit të Bibliotekës në Fundjavë).pdf; https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/; vizita në institucion]</i></p> |
| Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin periodik të fondit të bibliotekës sipas kërkesave të departamenteve, në pajtim me objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik afatgjatë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.2_(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025).pdf; Evidenca_Nr.76_(Proçedura për Pasurimin e Literaturës në Bibliotekë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |

| studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | | | | | | | | | |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Konkluzione | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</i> - <i>Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UAMD.</i> - <i>Institucioni angazhohet në përditësimin e fondit të bibliotekës (fizik dhe online) si dhe shkallën e shfrytëzimit të saj.</i> | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| | |
|---|--|
| Standardi IV.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Biznesit në bashkëpunim me departamentet përgjegjëse për programet e studimit janë strukturat që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi.</p> <p>Përveç dokumentacionit dhe arkivës letër, pranë UAMD përdoret edhe platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar, të arritjeve akademike & të lëshimit të diplomave) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtimit i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.7(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.8(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.11(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve” realizohet nga Struktura e Burimeve Njerëzore e UAMD dhe nga Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për këtë program studimi. Konkretisht, departamenti menaxhon dokumentacionin lidhur me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, ndërsa Struktura e Burimeve Njerëzore disponon dosjet e plota personale të të gjithë personelit të UAMD (me info si CV, dëshmi, kualifikime, raporte, kontrata, leje etj). Informacioni në dosjet përkatëse përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione etj. Gjatë takimit me specialistët e kësaj strukture, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet e dy pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi dhe konstatoi plotësinë e tyre</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtimit i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.7(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.8(Rregullore e Departamentit të Menaxhimit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD: si programet mësimore sipas cikleve</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; https://uamd.pitagora.rash.al/login; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Platforma PITAGORA është një aplikacion që zhvilluesit e RASH e kanë organizuar për të ofruar të gjitha funksionet e nevojshme për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundorë (studentët dhe pedagogët) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në kurse, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, kreditet e fituara, etj.</p> <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi përdorimin edhe të adresave zyrtare të emailit për një komunikim dhe shkëmbim më interaktiv të informacionit mes personelit akademik dhe studentëve, ndërkohë që faqja zyrtare në internet e UAMD dhe rrjetet sociale përdoren për komunikimin me publikun e gjerë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> | <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj. Gjithashtu, sipas parashikimeve në kuadrin rregullator të UAMD, personeli akademik plotëson regjistrin dhe listëprezencën si dokumente zyrtare të zhvillimit të mësimin. GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf;</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Evidenca_Nr.7_(Rregullore_e_Fakultetit_të_Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi_i_Sistemit_Elektronik).pdf; vizita në institucion]</i> | | | |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të internetit të UAMD publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Informacionet publikohen edhe në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit. Në gjuhën angleze gjenden të publikuara kryesisht informacionet lidhur me programet e studimit, kriteret dhe procedurat e aplikimit, [Referenca: <i>RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; https://uamd.edu.al/; Evidenca_Nr.63_(Njoftimet_në_rrjetet_sociale_të_Fakultetit_të_Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.88_(Të_Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD)_compressed.pdf; https://admissions.primesolutions.it/]</i> | | | |
| Konkluzione | GVJ konstaton se: <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UAMD. - Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UAMD. - Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, broshura të ndryshme promovuese të UAMD publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove të njësisë bazë sipas programeve apo cikleve të studimit, por vetëm në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkojnë me vitin buxhetor.</p> <p>Konkretisht, Administratori i UAMD, në bashkëpunim me Drejtorinë Administrimit Financiar, harton një raport financiar në nivel institucioni ku analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.96(Të dhëna progresive Janar 2023-Prill 2025).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të</p> | <p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas Statutit të UAMD, projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet nga Administratori i universitetit në përputhje me propozimet e bëra në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm përkatës (neni 38, germa a). Pas vlerësimit nga Senati Akademik (neni 15, germa r) projektbuxheti miratohet nga Bordi i Administrimit i UAMD. Në takimet me drejtuesit e FB dhe me personelin akademik të programit të studimit, GVJ konfirmoi se departamenti dhe fakulteti si pjesë të analizës vjetore përfshijnë edhe propozimet për parashikime financiare në funksion të programeve të studimit lidhur me botime, pjesëmarrje në konferenca, organizim i workshop-eve dhe vizitave studimore, pasurimin e bibliotekës etj.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>Sipas Statutit, kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UAMD. Kjo strukturë zhvillon aktivitetin në përputhje me Ligjin nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.</p> <p>Gjithashtu, UAMD si institucion buxhetor është objekt i auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). <i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.98_(Raporte Vjetore të Auditit të Brendshëm).pdf]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> | <p>Siç u përmend edhe më sipër, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi, por në nivel njësie kryesore. Administratori i UAMD, në bashkëpunim me Drejtorinë Administrimit Financiar, harton një raport financiar në nivel institucioni ku analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë. Ky raport diskutohet në të gjitha strukturat, sipas parashikimeve të kuadrit rregullator të UAMD dhe gjendet i publikuar edhe në faqen zyrtare në internet të institucionit,</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.96_(Të dhëna progresive Janar 2023-Prill 2025).pdf; https://uamd.edu.al/informacione-mbi-buxhetin/]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe</p> | <p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UAMD janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore.</p> |

| | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | <p>Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave shpërndahen në formë granti për politikën e zhvillimit të UAMD, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UAMD bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.96_(Të dhëna progresive Janar 2023-Prill 2025).pdf; vizita në institucion]</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti, por jo në nivel njësie bazë apo sipas programeve/cikleve të studimit.</i> - <i>Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UAMD dhe auditimit të jashtëm nga KLSH.</i> - <i>UAMD si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>GVJ konstaton se UAMD ka hartuar dhe zbaton statutin dhe rregulloren në përputhje me legjislacionin në fuqi, të cilat përcaktojnë qartë politikat dhe procedurat për pranimin, transferimin dhe largimin e studentëve. Dokumentacioni i dorëzuar konfirmon se këto akte janë të pajtueshme me ligjin, dhe se kandidatët për regjistrim në ciklin e studimeve duhet të përmbushin kriteret përkatëse dhe të ndjekin procedurat e publikuara nga universiteti.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>GVJ vlerëson se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Fakulteti i Biznesit garantojnë trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët, si gjatë procesit të pranimit, ashtu edhe gjatë zhvillimit të studimeve. Kjo sigurohet përmes politikave dhe procedurave institucionale që mbulojnë përzgjedhjen dhe formimin akademik të studentëve të programit Master Profesional “Drejtim i SME-ve”. GVJ konstaton se këto mekanizma janë të përputhshme me Statutin e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e programit Master Profesional dhe Rregulloren e NJSBC, duke garantuar një trajtim transparent dhe të harmonizuar me legjislacionin dhe standardet në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve); Evidenca_Nr.10_(Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë)]</i></p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>GVJ konstaton se kriteret specifike të pranimit për kandidatët në ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional “Drejtim i SME-ve”, përcaktohen qartë dhe bëhen të njohura nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Njësia Bazë përgjegjëse në fillim të çdo viti akademik. GVJ vlerëson se këto kriteret janë të publikuara në mënyrë transparente në faqen zyrtare të IAL, duke siguruar akses të barabartë dhe informacion të mjaftueshëm për kandidatët potencialë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.39_(Kriteret e Pranimit të Studentëve për 2023-2025); Evidenca_Nr.74_(Strategjia e Komunikimit UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>GVJ vlerëson se UAMD ka përcaktuar dhe bërë të qarta kriteret dhe procedurat për pranimin, seleksionimin, përparimin akademik, transferimin, njohjen e krediteve të mëparshme, vlerësimin dhe diplomimin e studentëve. Të gjitha këto informacione, duke përfshirë regjistrimin, tarifrat, bursat dhe mundësitë për transferim, publikohen në faqen zyrtare të UAMD dhe shpërndahen përmes rrjeteve sociale, duke garantuar qasje të drejtë dhe transparente për të gjithë kandidatët.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.60_(Programi i Transparencës UAMD; Evidenca_Nr.39_(Kriteret e Pranimit të Studentëve për 2023-2025; Evidenca_Nr.63_(Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.88_(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit ofrojnë një orientim të vazhdueshëm për kandidatët potencialë, duke u siguruar atyre informacion të detajuar mbi kriteret e pranimit në programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”. Kandidatët informohen jo vetëm për kërkesat akademike dhe procedurat e regjistrimit, por edhe për strukturën e programit, përmbajtjen e lëndëve, objektivat mësimore, si dhe mundësitë për përfshirje në aktivitete kërkimore dhe praktike, duke mundësuar një zgjedhje të informuar të rrugës së tyre akademike, siç konfirmohet nga dokumentacioni i dorëzuar në</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>dosjen e vetëvlerësimit dhe nga takimet gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.39_(Kriteret e Pranimit të Studentëve për 2023-2025; Evidenca_Nr.42_(Praktika për Transferim dhe Program të Dytë Studimi; Evidenca_Nr.88_(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> | <p>GVJ konstaton se, sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe bazuar në takimin me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë, kriteret dhe kuotat për programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, propozohet nga njësitë përkatëse dhe miratohen më pas nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, për t’u dërguar më pas pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kriterëve për grupet marginalizuara dhe kandidatët ndërkombëtarë realizohet në përputhje me udhëzimet e MAS.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.39_(Kriteret e Pranimit të Studentëve për 2023-202; Evidenca_Nr.94_(Kuotat e Pranimit të Studentëve; Evidenca_Nr.77_(Rregullore për studentët me aftësi të kufizuar)]</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> | <p>GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve janë të hartuara në përputhje me aktet nënligjore të MASR. Gjithashtu, GVJ vëren se këto kriteret janë të aksesueshme për publikun përmes faqes zyrtare të universitetit, duke garantuar transparencë dhe informim të plotë për kandidatët.</p> <p><i>[Evidenca_Nr.39_(Kriteret e Pranimit të Studentëve për 2023-2025)]</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> | <p>GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ofron informacion për bursat dhe ndihmën financiare të disponueshme për studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto përfshijnë bursa merite, përjashtime nga tarifat për studentët në nevojë dhe bursa sociale. GVJ vlerëson se politikat e universitetit synojnë të mbështesin studentët me performancë të lartë akademike, duke u mundësuar atyre të vazhdojnë studimet dhe të rrisin angazhimin e tyre gjatë ciklit të studimeve.</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>[Referenca: Evidenca_Nr.94_(Kuotat e Pranimi të Studentëve; Evidenca_Nr.77_(Rregullore për studentët me aftësi të kufizuar; Evidenca_Nr.89_(Mbështetja financiare për studentët)]</i> | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, ka vendosur dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta për pranimin, përparimin dhe diplomimin e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i> - <i>Kriteret e pranimi për Master Profesional "Drejtimit i SME-ve" janë të publikuara dhe të aksesueshme për publikun, duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.</i> - <i>Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit ofrojnë orientim të vazhdueshëm dhe informacion të detajuar mbi strukturën, përmbajtjen dhe mundësitë praktike të programit, duke mundësuar informim të plotë për studentët.</i> - <i>Universiteti siguron bursa dhe ndihmë financiare për studentët në nevojë dhe për ata me performancë të lartë, duke mbështetur vazhdimësinë e studimeve dhe rritjen e angazhimit akademik.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ vlerëson se studentët e programit Master Profesional në "Drejtimit i SME-ve", janë të informuar mirë për procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin, përfshirë kriteret për arritjen e rezultateve, numrin e krediteve të kërkuara dhe detyrimet akademike përkatëse. Procedurat janë të qarta, të dokumentuara dhe të përcaktuara në rregulloret institucionale të UAMD, përfshirë udhëzimet e detajuara të Rregullores së Universitetit mbi kalimin akademik. Sistemi elektronik "Pitagora" ofron akses të plotë |

| | |
|--|--|
| | <p>për studentët, duke u mundësuar ndjekjen e rezultateve, krediteve të fituara dhe detyrimeve akademike.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD); Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> | <p>GVJ konstaton se studentët janë të informuar mbi mundësitë dhe procedurat e transferimit, të cilat janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e UAMD dhe në dokumentacionin përkatës të programit, si dhe publikohen në faqen zyrtare të universitetit. Megjithatë, duke qenë se programi Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, ka një kohëzgjatje njëvjeçare, deri tani nuk janë regjistruar raste të transferimit të studentëve, referuar regjistrave dhe dokumnetacionit të depozituar në dosjen e vetëvlerësimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se në programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve”, kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve janë të qarta dhe të dokumentuara në rregulloren e programit. Syllabus-i i çdo lënde ofron informacion të detajuar mbi mënyrën e vlerësimit përkatës. Gjatë takimeve me studentët, GVJ konfirmoi se në javën e parë të çdo semestri, studentët e vitit të parë njoftohen në detaje mbi strukturën e programit, kriteret dhe procedurat e vlerësimit për çdo lëndë, duke siguruar një orientim të plotë dhe të kuptueshëm për fillimin e studimeve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve); Evidenca_Nr.13_(Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se procedurat dhe kriteret e diplomimit për programin Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” janë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për studentët, të shpërndara nga strukturat përkatëse përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Ato janë të harmonizuara me Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e Diplomimeve dhe Rregulloren e Mikrotezës.</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vërejti se studentët janë në procesin e përgatitjes së diplomës dhe procedurat e diplomimit. Informacioni u ofrohet studentëve përmes udhëheqësve të diplomës dhe udhëzuesit specifik të diplomës, i cili detajon çdo hap të procesit, duke siguruar orientim të qartë dhe mbështetje gjatë përfundimit të studimeve.</p> <p>Ky mekanizëm ofron mbështetje akademike dhe u mundëson studentëve të përmbushin kërkesat e programit dhe të arrijnë objektivat akademike të parashikuara, duke garantuar akses të barabartë për të gjithë studentët.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD); Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit); Evidenca_Nr.12_(Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstatoi se UAMD, Fakulteti i Biznesit dhe Departamentit të Menaxhimit, organizon çdo vit një sërë aktivitete informuese dhe promovuese për të tërhequr kandidatët e mundshëm. Këto aktivitete përfshijnë takime të hapura ku jepen detaje mbi programin e studimit, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin profesional të studentëve, si dhe krijojnë hapësirë për diskutime, feedback dhe sugjerime nga pjesëmarrësit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.88_(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD) Evidenca_Nr.101_(Guida e Studentit)]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - programi Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”, ofron një strukturë të qartë për menaxhimin e përparimit akademik të studentëve, përfshirë kalimin nga një vit në tjetrin, vlerësimin e dijeve dhe aftësive, procedurat e transferimit dhe kriteret e diplomimit. - Informacioni i nevojshëm për studentët është i aksesueshëm përmes rregulloreve institucionale, syllabus-eve, sistemit elektronik “Pitagora” dhe udhëzuesve specifikë, duke siguruar orientim dhe mbështetje gjatë ciklit të studimit master në “Drejtimit i SME-ve”. - UAMD, FB dhe DM zhvillojnë aktivitete të vazhdueshme informuese dhe promovuese për kandidatët e mundshëm, duke |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>siguruar informacion mbi strukturën e programit, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin profesional.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.3 | |
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | <p>GVJ konstaton se informimi mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”, fillon që në takimet e hapura me studentët potencialë. Studentët e pranuar marrin informacion të detajuar gjatë javës së orientimit kryesisht nga përgjegjësi i Departamentit dhe koordinatori i programit. Informacioni mbi organizimin e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe aktivitetet e tij, si dhe detaje të programit të studimit, janë të publikuara dhe përditësuar në faqen zyrtare të institucionit. GVJ konfirmoi saktësinë dhe qartësinë e këtyre mekanizmave gjatë takimeve me stafin dhe studentët.</p> <p><i>[Referenca: Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtimit i SME-ve)]</i></p> |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | <p>GVJ konstaton se studentët e programit Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”, njoftohen që nga dita e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Përmes sistemit “Pitagora”, ata kanë akses të vazhdueshëm në informacionin lidhur me lëndët, regjistrimet, orarin e mësimit dhe notat. Gjithashtu, orari mësimor dhe orari i provimeve publikohet dhe mbahet i përditësuar në faqen zyrtare të UAMD, duke siguruar qasje të plotë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët. Stafi akademik i programit sjell informacion të detajuar për syllabusin, organizimin, detyrimet dhe vlerësimin e çdo lënde.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.63_(Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.88_(Të Dhëna nga Faqja</i></p> |

| | |
|---|--|
| | <i>Zyrtare e Web-it e UAMD ; Evidenca_Nr.101_(Guida e Studentit; Evidenca_Nr.21_(Plani Mësimor në MP Drejtim i SME-ve]</i> |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | <p>GVJ konstaton se Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD ofron mbështetje për orientimin profesional të studentëve. Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës ofron informacion mbi mundësitë e praktikës dhe punësimit, ndërsa Panairi i Karrierës organizohet çdo vit për t'u prezantuar studentëve këto mundësi. Gjithashtu, GVJ konstaton se UAMD ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, duke mundësuar zhvillimin e praktikës dhe rritjen e mundësive profesionale për studentët.</p> <p><i>[Referenca: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca_Nr.69_(Karriera dhe Alumni UAMD, Kalendari i aktiviteteve dhe trajnimet; Evidenca_Nr.65_(Njoftime për punësim të studentëve dhe alumnit]</i></p> |
| Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | <p>GVJ konstaton se studentët janë të informuar mbi logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e studimeve. Orari mësimor publikohet në faqen zyrtare të internetit të UAMD, ndërsa studentët njoftohen mbi përdorimin e klasave, seminareve, bibliotekës, laboratorëve dhe mjediseve të tjera të studimit. Përmes guidës orientuese, studentët marrin gjithashtu informacion të detajuar mbi shërbimet dhe infrastrukturën që mbështet zhvillimin e tyre akademik, duke siguruar qasje të plotë dhe të harmonizuar me nevojat e programit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.68_(Biblioteka Online-Të dhëna mbi materialet e disponueshme); Evidenca_Nr.79_(Infrastruktura; Evidenca_Nr.97_(Informacion mbi paisjet hardware dhe software; Evidenca_Nr.43_(Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit; Evidenca_Nr.100_(Kalendari i Funksionimit të Bibliotekës në Fundjavë; Evidenca_Nr.101_(Guida e Studentit]</i></p> |
| Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit | <p>GVJ vëren se studentët kanë akses të plotë dhe të përditësuar në informacionin mbi programin e studimit përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave, me mundësi përdorimi edhe në distancë që është sistemi Pitagora. Për më tepër, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | sigurojnë shpërndarjen e informacionit për studentët edhe përmes rrjeteve sociale, email-it dhe kanaleve të tjera të komunikimit, duke garantuar informim të vazhdueshëm dhe mbështetje për orientimin akademik dhe menaxhimin e studimeve edhe jashtë ambientit fizik të UAMD. [Referenca: Evidenca_Nr.63_(Njoftimet në rrjetet sociale të Fakultetit të Biznesit; Evidenca_Nr.62_(Njoftime me e-mail Studentët e MP MB; Evidenca_Nr.90_(Njoftime për studentët; Evidenca_Nr.74_(Strategjia e Komunikimit UAMD)] | | | |
| Konkluzione | GVJ konstaton se: - Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës siguron një sistem të strukturuar dhe të qartë informimi për studentët e Masterit Profesional në “Drejtimit i SME-ve”. - Institucioni ofron informacion të detajuar mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit, duke mundësuar orientim të mirëinformuar dhe planifikim efektiv të rrugës akademike. - Studentët kanë akses të vazhdueshëm në këto informacione përmes sistemit elektronik “Pitagora”, rrjeteve sociale, email-it dhe guidave orientuese, ndërsa orientimi profesional mbështetet edhe nga Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. GVJ kontrollon rregjistrin themeltar të studentëve të rregjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë problematika. |

| | | | | | | | |
|--|---|----------------|------------|----------------|------------|----------------|------------|
| | <p>Sipas <i>Tabelat permbledhese</i> dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <table data-bbox="596 465 1058 622"> <tr> <td>Viti 2024-2025</td> <td>2 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2023-2024</td> <td>5 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2022-2023</td> <td>8 studentë</td> </tr> </table> <p><i>[Referenca: Tabelat permbledhese per Aneks RVB MP DSME.pdf; Evidenca Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit).pdf; vizita ne institucion]</i></p> | Viti 2024-2025 | 2 studentë | Viti 2023-2024 | 5 studentë | Viti 2022-2023 | 8 studentë |
| Viti 2024-2025 | 2 studentë | | | | | | |
| Viti 2023-2024 | 5 studentë | | | | | | |
| Viti 2022-2023 | 8 studentë | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni disponon dhe administron statistika të rregullta mbi numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet dhe largimet nga programi, të cilat ruhen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit. Një pjesë e këtyre të dhënave përfshihen dhe publikohen në raportin vjetor të institucionit, duke kontribuar në transparencën dhe monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë akademike.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca Nr.50_(Analiza Vjetore e FB 2023-2024).pdf; vizita ne institucion]</i></p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore e UAMD administron në mënyrë të rregullt dhe të digjitalizuar të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve, që nga momenti i pranimit deri në diplomim. Përmes sistemit të menaxhimit të informacionit “Pitagora”, studentët kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e tyre akademike, ndërsa stafi i sekretarisë mund të monitorojë në kohë reale progresin e tyre. Sistemi elektronik përlogarit mesataret semestrale dhe atë të përgjithshme, duke ofruar një pasqyrë të plotë dhe të detajuar të performancës akademike të çdo studenti.</p> | | | | | | |

| | |
|--|---|
| | <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtimi i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarinë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>GVJ konstaton se proceset e mbikëqyrjes dhe monitorimit në UAMD janë të përcaktuara qartë në rregulloren e institucionit dhe në atë të sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit “Pitagora”. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, u verifikua se të dhënat statistikore të studentëve arkivohen në mënyrë të rregullt dhe janë të verifikueshme vetëm nga persona të autorizuar. Aksesi në sistem është i personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse, qe siguron siguri dhe transparencë në administrimin e informacionit. GVJ, përmes verifikimeve rastësore të të dhënave të studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të ecurisë akademike, nuk konstatoi mangësi në menaxhimin dhe ruajtjen e tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtimi i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.11_(Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita ne institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>GVJ vëren se institucioni ka në funksion mekanizma për analizimin e profileve dhe cilësisë së studentëve të programit Master Profesional “Drejtim i SME-ve”, që nga momenti i pranimit deri në përfundim të studimeve. Sekretaria Mësimore përpunon periodikisht të dhëna mbi rezultatet akademike të studentëve, ndërsa Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban kontakte me të diplomuarit për të evidentuar ecurinë e tyre në tregun e punës. Përveç kësaj, Departamenti i Menaxhimit zhvillon analiza të rregullta mbi tregun e punës dhe performancën e të diplomuarve, të cilat shqyrtohen në mbledhjet departamentale me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtimi i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit).pdf; Evidenca_Nr.71_(Të</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Dhëna nga Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit).pdf; vizita ne institucion]</i> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton dhe vlereson se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Sekretaria Mësimore e UAMD administron në mënyrë korrekte dhe të digjitalizuar të dhënat mbi regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve, duke siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri në çdo fazë të procesit akademik.</i> - <i>Sistemi elektronik "Pitagora" funksionon si mjet efektiv për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e të dhënave akademike, duke mundësuar akses të personalizuar për studentët dhe stafin.</i> - <i>Proceset e mbikëqyrjes dhe ruajtjes së të dhënave janë të standardizuara dhe të mbrojtura, duke respektuar parimet e sigurisë dhe konfidencialitetit.</i> - <i>Institucioni analizon në mënyrë periodike profilin dhe performancën e studentëve, si dhe ecurinë e të diplomuarve në tregun e punës, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | <p>GVJ vëren se Statuti i UAMD garanton përfshirjen aktive të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Studentët marrin pjesë si anëtarë me të drejta përfaqësimi në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit;</i></p> |

| | |
|--|---|
| | <i>Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve]</i> |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | <p>GVJ konstaton se, në përputhje me Statutin e UAMD, studentët marrin pjesë në proceset vendimmarrëse përmes përfaqësimit të tyre në Senatin Akademik, Bordin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi se UAMD ndërmerri veprime konkrete për të informuar dhe orientuar studentët lidhur me të drejtat e tyre dhe rolin e tyre përfaqësues në strukturat institucionale, duke krijuar hapësira për shprehjen dhe adresimin e shqetësimeve të tyre. Gjithashtu, përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit mësimor përmes pyetësorëve të administruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbën një mekanizëm të qëndrueshëm që kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe në përshtatjen më të mirë të tyre me nevojat e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.93_(Përfshirja e Studentëve në Vendimmarrje, Këshillim, Vlerësim; Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD; Evidenca_Nr.30_(Anketimi i Studentëve në Fakultetin e Biznesit; Evidenca_Nr.31_(Formulari i Vlerësimit për Pedagogët nga Studentët]</i></p> |
| Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | <p>GVJ vëren se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Fakulteti i Biznesit përfshijnë studentët në proceset e zhvillimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Nga takimet me përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe me studentët, rezultoi se ata marrin pjesë aktivisht në vlerësimin e cilësisë së programit Master Profesional “Drejtim i SME-ve”, përmes pyetësorëve të administruar çdo semestër, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.30_(Anketimi i Studentëve në Fakultetin e Biznesit; Evidenca_Nr.31_(Formulari i Vlerësimit për Pedagogët nga Studentët; Evidenca_Nr.91_(Sondazhi Kombëtar i Studentëve dhe Takimi informuese 4 Prill 2025]</i></p> |
| Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së | <p>GVJ vëren se rregullorja e institucionit si dhe ajo e PS në “Drejtim i SME-ve”, paraqesin kriteret e vlerësimit dhe sigurojnë objektivitet dhe barazi në vlerësimin e dijës së studentëve. Ato përcaktojnë të drejtën e studentëve për ankim,</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>rishikim dhe përmirësim të rezultateve të provimeve, si dhe procedurat që institucioni duhet të ndjekë në çdo rast. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ky informacion u bëhej i njohur atyre dhe se të drejtat përkatëse janë respektuar sipas nevojës.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.93_(Përfshirja e Studentëve në Vendimmarrje, Këshillim, Vlerësim; Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve; Evidenca_Nr.40_(Studimi i Tregut të Punës për Master Profesional në Drejtim i SME-ve)]</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i UAMD siguron përfshirjen aktive të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. - Institucioni ndërmerr masa për të informuar studentët mbi të drejtat dhe rolin e tyre përfaqësues, duke krijuar mundësi për shprehjen e shqetësimeve dhe kontribimin në vendimmarrje. - Studentët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së programit Master Profesional "Drejtim i SME-ve" përmes pyetësorëve semestrialë, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe përshtatjen me nevojat e tyre. - Rregullorja e institucionit dhe ajo e programit përcaktojnë kriteret e vlerësimit, duke garantuar objektivitet dhe barazi në kontrollin e dijeve. Studentët kanë të drejtë për ankim, rishikim dhe përmirësim të rezultateve të provimeve, të drejta këto që respektohen dhe u bëhen të njohura atyre. | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet</p> | <p>GVJ vëren se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka strukturuar burimet njerëzore në njësi të veçanta për ofrimin e informacionit dhe shërbimeve të ndryshme ndaj studentëve, duke respektuar detyrimet ligjore dhe rregulloret përkatëse të institucionit, siç është drejtorja e administrimit të shërbimeve</p> |

| | |
|---|---|
| <p>ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> | <p>akademike, sekretaria mesimore, sektori i komunikimit, alumnit dhe karrierës etj.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.78(Struktura Organizative e UAMD dhe FB; Evidenca_Nr.88(Të Dhëna nga Faqja Zyrtare e Web-it e UAMD; Evidenca_Nr.60(Programi i Transparencës UAMD; Evidenca_Nr.74(Strategjia e Komunikimit UAMD; Evidenca_Nr.70(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike)]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>GVJ vëren se, janë krijuar njësi funksionale dhe të dedikuara për shërbimin e studentëve, si Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës. Rregulloret e institucionit parashikojnë përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse, këshilluese dhe në ato për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies, duke u mundësuar të kontribuojnë në çështjet që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Njësitë në shërbim të studentit organizojnë gjithashtu aktivitete të tilla si ditët e orientimit, panairt e punës dhe fushata informuese për të promovuar shërbimet që ofrojnë.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>GVJ vëren se gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës u konstatua se zyra ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe orientimi për studentët, si për ata që sapo fillojnë studimet, ashtu edhe për të diplomuarit. Shërbimet përfshijnë informacion mbi pjesëmarrjen në konferenca studentore, programe shkëmbimi jashtë vendit, trajnime, shkolla verore dhe realizimin e praktikave profesionale pranë institucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.70_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca_Nr.65_(Njoftime për punësim të studentëve dhe alumnit; Evidenca_Nr.69_(Karriera dhe Alumni UAMD, Kalendari i aktiviteteve dhe trajnimit)]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,</p> | <p>GVJ vëren se Zyra e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës mban nën monitorim ecurinë e studentëve pas diplomimit, duke përdorur një bazë të dhënash të organizuar</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | mbi të diplomuarit. Sipas GVJ, zyra zhvillon çdo vit vrojtime me ish-studentët dhe rezultatet e këtyre analizave i bëhen të disponueshme departamenteve përkatëse, ndërkohë që një përmbledhje publikohet në faqen zyrtare të Zyrës. <i>[Referenca: Evidenca_Nr.71_(Të Dhëna nga Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit; Evidenca_Nr.92_(Histori Suksesi Alumni; Evidenca_Nr.70_(Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca_Nr.73_(Përdorimi i Sistemit Elektronik; Evidenca_Nr.33_(Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar)]</i> | | | |
| Konkluzione | GVJ vlerëson se: - institucioni ka krijuar struktura funksionale dhe efektive për orientimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe për menaxhimin e ankimimeve dhe çështjeve të ndryshme. - Këto struktura operojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe ofrojnë akses të drejtpërdrejtë për studentët. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

| | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të | Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. |

| | |
|--|---|
| <p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> | <p>Në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me parashikimet në syllabuset e lëndëve dhe me praktikat më të mira bashkëkohore si prezantime me powerpoint, prezantimi i rasteve studimore, ndarja në grupe pune, diskutimet e lira, etj. Gjithashtu, ata konfirmuan disponimin e udhëzuesve për përdorimin e sistemeve IT të UAMD, platformës PITAGORA për studentët dhe për pedagogët dhe bibliotekës online.</p> <p>Plani Strategjik i UAMD i kushton vëmendje përdorimit të metodologjive të reja dhe mësimdhënis inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025).pdf; Evidenca_Nr.3(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025).pdf; Evidenca_Nr.67(Manual Biblioteka Online).pdf; Evidenca_Nr.73(Përdorimi i Sistemit Elektronik).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>GVJ konstatoi se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave; ▪ Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë; ▪ Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin e studimit. <p>Në përputhje parashikimet në Statutin dhe Rregulloren për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, të UAMD-së, këto struktura planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të institucionit lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti (analizat vjetore përkatëse). Gjithashtu, në nivel departamenti</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>mekanizmat e vlerësimit përfshijnë dosjet e vetëvlerësimit të personelit akademik, vlerësimin nga drejtuesi i departamentit lidhur me treguesit e punës mësimore dhe kërkimore etj.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FB dhe Rregullorja e këtij programi studimi parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt plotësimit të një formulari, që dorëzohet pranë zyrës së Dekanit të Fakultetit dhe shqyrtohet sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara (neni 120 i rregullores UAMD).</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca_Nr.6_(Rregullore e UAMD).pdf; Evidenca_Nr.7_(Rregullore e Fakultetit të Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.9_(Rregullore e Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se NJBSC dhe strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave hartojnë raporte (mbi pyetësorët e studentëve, zhvillimin e mësimin, ecurinë e akreditimit etj.), që u paraqiten strukturave drejtuese të institucionit dhe përmes tyre informohet në mënyrë konfidenciale edhe personeli akademik me synim përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Gjithashtu, këto raporte bëhen pjesë edhe e analizave vjetore që realizohen në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p><i>Megjithatë GVJ konstaton se publikimi i tyre në faqen zyrtare të institucionit është mjaft i përmbledhur dhe ka nevojë të përditësohet.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.30_(Anketimi i Studentëve në Fakultetin e Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.50_(Analiza Vjetore e FB 2023-2024).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Në takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe personelin akademik të këtij programi studimi, si dhe me përfaqësues të NJSBC, gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se rezultatet e vlerësimeve me pyetësorë të studentëve si dhe dosjet e vetëvlerësimit të personelit akademik janë pjesë e analizave në departament me qëllim përmirësimin e mëtejshëm dhe promovimin e praktikave më të mira.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.50_(Analiza Vjetore e FB 2023-2024).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UAMD ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. - Kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. - Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, dosjet e vetëvlerësimit të personelit akademik, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti. |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | - UAMD angazohet për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi VI.2 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, Statutit dhe Rregulloreve të UAMD, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Në nivel institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Senati Akademik ▪ Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) ▪ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) ▪ Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) ▪ Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve ▪ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program ▪ Koordinatorët e Programeve <p>Në Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, fokus i veçantë i kushtohet promovimit të një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë.</p> <p>[Referenca: Evidenca Nr.1(Statuti i UAMD).pdf; Evidenca Nr.2(Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>2025).pdf; https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/; Info shtese 1. Evidenca_Nr.107(Strukturat per Garantimin e Cilesise).pdf; 6. Evidenca_Nr.10.1(Rregullore e rishikuar per Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit te Brendshem te Sigurimit te Cilësisë).pdf; 7. Evidenca_Nr.105(Raport Vjetor i NJSBC).pdf]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>Gjithashtu, GVJ konstatoi se në nivel UAMD është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me gjashtë anëtarë nga personeli akademik dhe një anëtar përfaqësues i studentëve, si dhe në Fakultetin e Biznesit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC e Fakultetit) me 6 anëtarë nga personeli akademik. Këto struktura zhvillojnë aktivitetin në përputhje me parashikimet në Statutin e UAMD-së dhe Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Ndërkohë një përfaqësues i studentëve dhe një bashkëpunëtor i jashtëm (përfaqësues i biznesit) janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p>Edhe në planet e zhvillimit strategjik të Fakultetit të Biznesit dhe të Departamentit të Menaxhimit identifikohen qartë vizioni, objektivat, si dhe prioritetet për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të strukturave dhe të gjithë sistemit të sigurimit të cilësisë.</p> <p>[Referenca: Evidenca_Nr.3(Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025).pdf; Evidenca_Nr.4(Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Menaxhimit 2021-2025).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1(Rregullore e rishikuar për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/; vizita në institucion]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si</p> | <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit në bazë të parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore.</p> <p>Konkretisht, me vendimin Nr.03 të Bordit të Akreditimit, datë 22.01.2021 programi i studimit Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” ka marrë akreditimin me kohëzgjatje 2 vite</p> |



| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi ka përfunduar më 30.09.2023.</p> <p>Ndërsa me vendimin Nr.18 të Bordit të Akreditimit, datë 24.03.2022 UAMD ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 23.03.2026.</p> <p>[Referenca: https://ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-22-janar-2021; https://ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-24-mars-2022; vizita në institucion]</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>GVJ vlerëson se në rregulloret e UAMD paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, dosjet e vetëvlerësimit të personelit akademik për aktivitetin mësimor dhe kërkimor, si dhe treguesit kyç të performancës që përfshihen në analizat vjetore të ecurisë të realizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti. GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e personelit akademik përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit me objektiv rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti_i_UAMD).pdf; Evidenca_Nr.17_(Analiza_për_Programin_e_Studimit_Master_Profesional_Drejtim_i_SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza_Vjetore_e_Departamentit_të_Menaxhimit_2023-2024).pdf; Info_shtese_6_Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore_e_rishikuar_për_Funksionimin_dhe_Organizimin_e_Sistemit_të_Brendshëm_të_Sigurimit_të_Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në UAMD procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. - Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, dosjet e vetëvlerësimit të personelit akademik, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti. | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se kuadri rregullator i UAMD parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë. Në mënyrë më specifike Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë parashikon sigurimin e cilësisë (neni 6) përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie me instrumenta si pyetësorët e studentëve dhe vlerësimit të personelit akademik nga përgjegjësi i departamentit; ▪ vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të institucionit me pyetësorët për studentët, personelin akademik dhe personelin administrativ; ▪ vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit bazuar në praktikat, kriteret dhe standardet më të mira të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe modelet e brendshme të institucionit; ▪ vlerësimit të cilësisë së studentëve, të personelit akademik dhe të cilësisë së kërkimit shkencor bazuar në kriteret, standarde dhe tregues kyç të hartuar në përputhje me politikën dhe strategjinë e institucionit. <p>Në nivel universiteti, Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave ndjek problemet lidhur me mësimin, statistikave përkatëse, mbarëvajtjen e procesit të akreditimit, aspektet formale të përgatitjes së programeve të rinj të studimit për të gjithë ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UAMD.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.1_(Statuti i UAMD).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjet në fund të çdo semestri mësimor, Departamenti i Menaxhimit analizon ecurinë dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse. Për secilin prej këtyre aspekteve evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.</p> <p>Gjithashtu, NJSBC e Fakultetit të Biznesit përgatit një raport vjetor ku evidentohen objektivat dhe metodologjia e përgatitjes dhe analizohet në nivel fakulteti ecuria lidhur me menaxhimin dhe infrastrukturën e FB, programet e studimit, procesin mësimor, kërkimin shkencor, studentët dhe mbështetjen e tyre.</p> <p>Në nivel universiteti, Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave që ka në varësi Sektorin e Sigurimit të Cilësisë, Sektorin e Kurrikulës dhe Regjistrimeve, si dhe Sektorin e Akreditimit dhe Statistikës, harton raporte periodike të vetëvlerësimit të veprimtarisë mësimore të UAMD që i prezantohen Senatit Akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza_Vjetore_e_Departamentit_të_Menaxhimit_2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.30_(Anketimi_i_Studentëve_në_Fakultetin_e_Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza_e_Marrëveshjeve_të_Bashkëpunimit).pdf; Info_shtese_7.Evidenca_Nr.105_(Raport_Vjetor_i_NJSBC).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p> | <p>Në takimet me drejtuesen e Departamenti të Menaxhimit dhe personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në UAMD përdoren procedura formale për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> |

| | |
|--|--|
| <p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik; ▪ në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies; ▪ monitorime të procesit mësimor & analiza në mbledhjet e departamentit; ▪ përditësimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe plotësimi i formularit të vlerësimit të performancës nga personeli akademik etj. <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.27_(Analiza_Vjetore_e_Departamentit_të_Menaxhimit_2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.30_(Anketimi_i_Studentëve_në_Fakultetin_e_Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.31_(Formulari_i_Vlerësimit_për_Pedagogët_nga_Studentët).pdf; Evidenca_Nr.32_(Modele_për_Vlerësimin_e_Performancës_së_Pedagogut).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> | <p>Në kuadër të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit GVJ konstaton angazhimin e institucionit jo vetëm në realizimin e anketimeve me studentët dhe të intervistave me punëdhënësit gjatë aktiviteteve si panairi i karrierës, por edhe në analiza përmes pyetësorëve të strukturuar drejtuar palëve të treta për të vlerësuar përfitimet e bashkëpunimit si dhe hapësirat për zhvillime dhe përmirësime të mëtejshme.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.30_(Anketimi_i_Studentëve_në_Fakultetin_e_Biznesit).pdf; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza_e_Marrëveshjeve_të_Bashkëpunimit).pdf; Info_shtese_6.Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore_e_rishikuar_për_Funksionimin_dhe_Organizimin_e_Sistemit_të_Brendshëm_të_Sigurimit_të_Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se: - Kuadri rregullator i UAMD parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>- Në raportet e analizës në nivel Departamenti dhe Fakulteti evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.</p> <p>- UAMD përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Në Statutin e UAMD (kreu 7) paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në institucion, roli i strukturave akademike, administrative dhe i komisionit të përhershëm në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UAMD.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1(Statuti i UAMD).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1(Rregullore e rishikuar për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë</p> | <p>GVJ konstaton se në Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohen strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, organizimi, detyrat, funksionet dhe</p> |

| | |
|--|---|
| <p>të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>përgjegjësitë e tyre, standardet kryesore dhe mënyrat e vlerësimit të cilësisë, metodologjia dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1(Rregullore e rishikuar për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademiq e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Pranë UAMD është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me gjashtë anëtarë nga personeli akademik dhe një anëtar përfaqësues i studentëve. Edhe në Fakultetin e Biznesit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC e Fakultetit) me 6 anëtarë nga personeli akademik, ndërkohë një përfaqësues i studentëve është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.1(Statuti i UAMD).pdf; Info shtese 1. 6. Evidenca_Nr.10.1_ (Rregullore e rishikuar për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; Evidenca_Nr.107(Strukturat per Garantimin e Cilesise).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>GVJ vlerëson se UAMD garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p>Në Kodin e Etikës së UAMD jepen parimet e etikës universitare dhe publike të detyrueshme për të gjithë, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, si edhe shprehet qartë angazhimi i UAMD për respektimin e integritetit dhe shmangien e diskriminimit duke trajtuar në mënyrë të kujdesshme të gjitha problemet etike të studentëve dhe personelit gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.16_(Kodi i Etikës në UAMD).pdf; vizita në institucion]</i></p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>GVJ konstaton se UAMD ka krijuar një traditë në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si anëtarë të grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Gjithashtu, aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë pjesë e pandarë e jetës universitare të UAMD dhe shfrytëzohen nga institucioni për mbledhjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.37.1_(Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Menaxhimit).pdf; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit).pdf; vizita në institucion]</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i UAMD përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>UAMD siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet kryesisht përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, përfshirjes në grupet e vlerësimit të brendshëm, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private.</i> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |




| Standardi VI.5 | |
|--|---|
| Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin për informim të publikut të të gjitha veprimtarive të kryera përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p>Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare, memove dhe emaileve në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen në mënyrë periodike përmes takimeve informuese, publikimeve në faqen zyrtare të internetit të UAMD dhe në rrjetet sociale, si dhe komunikimeve në platformën PITAGORA.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.60_(Programi i Transparencës UAMD).pdf; https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. <i>Megjithatë, GVJ konstaton se keto publikime janë shumë përmbledhëse dhe kanë nevojë të përditësohen.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.60(Programi i Transparencës UAMD).pdf; https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe</p> | <p>Në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ u informua se në mbledhjet e Departamentit të Menaxhimit, personeli akademik diskuton në mënyrë aktive ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjeron rekomandime në</p> |

| | |
|---|---|
| <p>synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve, si dhe bazuar në propozimet e bëra nga personeli akademik, hartohet raporti i analizës vjetore në nivel departamenti i cili shoqërohet me konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe të problematikave të evidentuara.</p> <p>Gjithashtu, raportet e NJSBC mbi analizën e pyetësorëve u përcillen njësisë bazë dhe diskutohen nga personeli akademik, duke theksuar praktikat pozitive dhe duke marrë masa dhe dhënë rekomandime për përmirësimin e gjetjeve.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.37.4_(Analiza e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UAMD parashikon përdorimin e dhënave statistikore dhe treguesve kyç të performancës për vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të monitorimit dhe përmirësimin të vijueshëm të cilësisë.</p> <p>Raportet e analizave vjetore të zhvilluara në nivel departamenti dhe fakulteti përfshijnë tregues si niveli i kalueshmërisë, vlerësimi i studentëve, mesatarja e studentëve, numri i të diplomuarve etj., si dhe shoqërohen me konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: Evidenca_Nr.17_(Analiza për Programin e Studimit Master Profesional Drejtim i SME-ve).pdf; Evidenca_Nr.27_(Analiza Vjetore e Departamentit të Menaxhimit 2023-2024).pdf; Evidenca_Nr.50_(Analiza Vjetore e FB 2023-2024).pdf; Info shtese 6. Evidenca_Nr.10.1_(Rregullore e rishikuar për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë).pdf; vizita në institucion]</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe</p> | <p>Në takimet me dekanin e Fakultetit të Biznesit dhe drejtuesen e Departamentit të Menaxhimit, si dhe me personelin akademik të këtij program studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit dhe përkushtimin e personelit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit përmes analizave</p> |

| | | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------------------|
| përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | <p>dhe veprimtarive periodike me pedagogët dhe studentët në funksion të këtij kriteri, përmes përditësimit të materialeve mësimore, përmes publikimeve të ndryshme në faqen zyrtare të internetit të UAMD me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: RVB Master Profesional Drejtim i SME-ve_compressed.pdf; Evidenca_Nr.91_(Sondazhi Kombëtar i Studentëve_dhe Takimi informuese 4 Prill 2025)_compressed.pdf; vizita në institucion]</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UAMD publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë të interesuarve. - Publikimet në faqen zyrtare të internetit të UAMD dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. - Në raportet e analizës në nivel Departamenti përfshihen tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. - UAMD angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |

| | | | | |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht X |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------------------|




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Drejtim i SME-ve” ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Pikat e forta dhe afirmime


1. Përgatitja dhe angazhimi i personelit akademik të programit të studimit.
2. Infrastruktura fizike e përshtatshme për një proces mësimor efektiv.
3. Larmia e marrëveshjeve të bashkëpunimit që lehtësojnë kryerjen e praktikave profesionale të lidhura me programin e studimit.
4. Angazhimi aktiv në projekte kërkimore dhe shkencore, me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë.

Pika të dobta

1. Rregullorja e programit të studimit është e përgjithshme dhe ka disa pasaktësi lidhur me misionin apo kushtet e diplomimit të studentëve. *[Referenca: Fusha III, Standardi III.4, Standardi III.5]*
2. Struktura e planit mësimor nuk përputhet plotësisht me emërtimin e programit të studimit, duke zvogëluar qartësinë e profilit profesional dhe orientimin praktik të programit të studimit. *[Referenca: Fusha II, Standardi II.4, Standardi II.5; Fusha III, Standardi III.4]*
3. Disa prej programeve lëndore (syllabuset) kanë literaturë bazë dhe ndihmëse relativisht të vjetëruar dhe një formatim jo plotësisht në përputhje me bazën ligjore. *[Referenca: Fusha II, Standardi II.3, Standardi II.4]*

Rekomandime

1. Institucioni duhet të përditësojë dokumentat kryesorë strategjikë në përputhje me zhvillimet dhe parashikimet për të ardhmen e institucionit dhe të programeve të studimit përtej vitit 2025, për të paktën 3-4 vitet në vijim.
2. Institucioni duhet të rishikojë dhe saktësojë rregulloren e këtij programi studimi.
3. Institucioni duhet të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, për një lidhje më të qartë ndërmjet emërtimit të programit dhe strukturës së kurrikulës, në funksion të profilit profesional dhe orientimit praktik të programit të studimit.
4. Institucioni duhet të përditësojë literaturën dhe formatin e programeve lëndore (syllabuseve) të këtij programi studimi, në përputhje me bazën ligjore.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Management of SMEs" provided by UAMD

Strengths and affirmations

1. The quality and the commitment of the academic staff engaged in the study program Professional Master in "Management of SMEs".
2. The adequate infrastructure and facilities for effective teaching and learning.
3. The variety of cooperation agreements facilitates the completion of professional internships related to the study program.
4. Active engagement in research and scientific projects, with local and international partners.

Weaknesses

1. The Regulation of study program Professional Master in "Management of SMEs" is generic and contains some inaccuracies regarding the program's mission or the degree requirements of the students. *[Chapter III, Standard III.4, Standard III.5]*
2. The structure of the curriculum does not fully correspond to the name of the study programme, reducing the clarity of its professional and practical profile. *[Chapter II, Standard II.4, Standard II.5; Chapter III, Standard III.4]*
3. Some syllabuses have relatively outdated basic and auxiliary literature, and a format not fully in line with the legal basis. *[Chapter II, Standard II.3, Standard II.4]*

Recommendation

1. The institution should update key strategic documents in line with its developments and forecasts for the future of the institution and its curricula beyond 2025, at least for the next 3-4 years.
2. The institution should review and correct the regulation of this study program.
3. The institution should review the curriculum content of this study program, to ensure a clearer connection between the program name and the curriculum structure, in line with its professional and practical profile.
4. The institution should update the literature and the format of some of the syllabuses of this study program, in accordance with the legal basis.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | Nuk përbushen | Përbushen pjesërisht | Përbushen kryesisht | Përbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | X | |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

